

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6161
E martë, 10 nëntor 2020
çmimi 0.40 €

Zemaj paralajmëron
masa të reja, Ahmeti
thotë se Prishtina mund
të mbyllet për një javë

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

HASHIM THAÇI DHE JAKUP KRASNIQI JANË PARAQITUR TË HËNËN PARA
DHOMAVE TË SPECIALIZUARA NË HAGË

THAÇI DHE KRASNIQI PARA SPECIALES: AKUZAT JANË TË PAQËNDRUESHME



Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, janë deklaruar të pafajshëm për të gjitha pikat e aktakuzës për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit të ngritura nga Dhomat e Specializuara në Hagë. Gjatë paraqitjes së parë të tyre në Hagë ata kanë deklaruar se ndihen të pafajshëm. Ndërsa



avokatët e tyre kanë paralajmëruar se në javët në vijim do ta dorëzojnë kërkesën për lirimin e përkohshëm të tyre. Ndërsa avokati i Thaçit, David Hooper, e ka pyetur gjykatën se ku janë akuzat për vjedhje të organeve të njerëzve dhe e ashtuquajtura Shtëpi e Verdhë, që kanë qenë arsyet kryesore për themelimin e Gjykatës Speciale ■ FAQE 4-5

ZHVILLIMET AKTUALE NË VEND, FILLON BASHKËPUNIMI INSTITUCIONAL DHE PARTIAK

Pas zhvillimeve të fundit në vend, konkretisht konfirmimit të aktakuzave nga Gjykata Speciale për ish-presidentin Hashim Thaçi, ish-kryetarët e Kuvendit të Kosovës, Kadri

Veseli dhe Jakup Krasniqi, dhe deputetit Rexhep Selimi, ushtruesja e detyrës e presidentit, Vjosa Osmani dhe kryeministri Avdullah Hoti kanë zhvilluar të hënën një takim për

bashkërendim ndërinstitucional. Po ashtu, edhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka zhvilluar një takim me përfaqësues të PDK-së dhe të Nismës Socialdemokrate ■ FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



ISH-UDHËHEQËSIT E UÇPMB-së:
LUFTA E UÇK-së KA QENË E
PASTËR F. 5

TË MËRKURËN SEANCA
PËR SHOYRTIMIN E DYTË
TË PROJEKTLIGJIT PËR
RIMËKËMBJEN EKONOMIKE F. 3

PËRFAQËSUESIT E KOMUNAVE
SHOIPTARE NË RAJON
DISKUTOJNË PËR PANDEMËN F. 10

EKONOMI

SEKRETI I FINANCIMIT TË
PARTIVE POLITIKE F. 8

SHTYHET PROTESTA
E PUNËTORËVE TË TELEKOMIT,
JEPET EDHE NJË JAVË
KOHË PËR DIALOG F. 8



KULTURË

Reportazh
PËRSKAJ VARRIT MË
TË THELLË NË BOTË,
SHPELLËS SË AZEM GALICËS F. 12



Nga e mërkura, nga ora 22:00-06:00, Shqipëria në karantinë

Komiteti Teknik i Ekspertëve në Shqipëri, nisur nga numri i lartë i të prekurve me Covid-19, ka vendosur që ta kufizojë lëvizjen nga e mërkura prej orës 22:00 deri në orën 6:00 të mëngjesit



TIRANË, 9 NËNTOR (ER) - Komiteti Teknik i Ekspertëve në Shqipëri ka mbajtur një konferencë të jashtëzakonshme, në të cilën ka paraqitur marrjen e disa masave shtesë në luftën kundër Covid-19. Pas kësaj konference, është nxjerrë ky vendim: nga e mërkura dhe për tri javë rresht ndalohet dalja e qytetarëve në orët 22:00-06:00. Gjithashtu, do të kufizohet edhe orari i bareve dhe restoranteve në orët 22:00-06:00 në mëngjes. Komiteti ka propozuar që administrata publike të punojë nga shtëpia në rastet kur është e mundur. “Kemi analizuar hollësisht rezultatin e masave të marra deri më tani si dhe përvojën e vendeve përreth. Kemi shënuar se në Shqipëri është vënë re shtim i transmetueshmërisë së infeksionit. Është rritur edhe incidenca. Në kushtet ku nuk ka ende një kurrë, mënyra më e mirë është parandalimi. Duke analizuar shifrat, shkaqet, rekomandimet e

organizatës së OBSH-së, komiteti propozon të merren disa masa në përputhje me strategjinë tonë vjeshtë-dimër. Ne vlerësojmë se duhet t'i marrim këto masa dhe i konsiderojmë ato të domosdoshme për pengimin e përhapjes së këtij infeksioni. Masa që ne kemi vendosur është izolimi i vendit nga ora 22:00 deri në orë 06:00. Lokalet dhe restorantet duhen mbyllur pas orës 22:00, përveç shërbimeve ‘delivery’. Hyjnë në fuqi të mërkurën, më datë 11. Rishikohen çdo javë”, është shprehur shprehur zëvendësministria e Shëndetësisë, Mira Rakacolli. Ajo ka folur edhe në lidhje me mbylljen e shkollave, duke theksuar se nuk janë një vatrë infeksioni dhe tani për tani nuk ka një vendim për mbylljen e tyre. Sipas saj, vendimi do të merret hap pas hapi në varësi të rasteve të reja që do të paraqiten, ndërsa Komiteti i Ekspertëve do të bëjë rivlerësim të situatës. “Unë shpjegoj çdo masë që

merret bëhet në bazë të shifrave dhe arsyes se pse janë këto shifra. Neve na rezulton që në shkolla të ketë shpërndarje të infeksionit më të madhe se më parë. Nuk i kemi shkollat vatra infeksioni. Ne po monitorojmë me shumë kujdes dhe masat merren në vazhdim të situatës epidemiologjike. Shohim fenomenin, zbulojmë faktorët dhe shohim çfarë mund të bëjmë për parandalimin. Sot për sot shkollat nuk kanë influencuar në një rëndim të madh të situatës”, ka thënë Rakacolli.

525 raste të reja dhe 12 të vdekur në 24 orët e fundit në Shqipëri

Gjatë 24 orëve të fundit në Shqipëri janë kryer 1 967 testime, nga të cilat kanë rezultuar pozitivë 525 qytetarë të prekur nga virusi Covid-19. Rastet pozitive të konfirmuara në 24 orët e fundit janë identifikuar në këto bashki: 222 raste në Tiranë, 38 në Shkodër, 24 në Durrës, nga 21 raste në Krujë, Vlorë, 20 në

Berat, 18 në Kukës, nga 15 raste në Kuçovë, Elbasan, 14 në Librazhd, 11 në Lushnjë, nga 10 raste në Korçë, Përmet, Malësi e Madhe, Gramsh, 9 në Pogradec, nga 8 raste në Kurbin, Kavajë, Skrapar, nga 6 raste në Fier, Mat, nga 5 raste në Dibër, Peqin, 4 në Tropojë, nga 2 raste në Lezhë, Sarandë, Bulqizë, 1 në Devoll.

Disa liderë shtetesh ende nuk e kanë uruar Bidenin

UASHINGTON, 9 NËNTOR - Presidenti rus Vladimir Putin nuk do ta përgëzojë presidentin e zgjedhur amerikan, Joe Biden, derisa të zgjidhen sfidat ligjore për zgjedhjet në ShBA dhe rezultati të jetë zyrtar, njoftoi Kremli në hënën, transmeton AP. Putini është një nga liderët botërorë që nuk e ka komentuar fitoren e Bidenit, e cila është njoftuar nga mediat më të mëdha. Ekipi i presidentit Donald Trump ka premtuar veprime ligjore në ditët në vijim dhe Trump ende nuk e ka pranuar humbjen e tij, ndërsa pretendon se ka pasur mashtrim në shkallë të gjerë të votuesve deri më tani, pa ofruar prova. Kur Trump fitoi më 2016, Putini ishte i shpejtë në urimin ndaj tij, por sfiduesja e Trumpit në ato zgjedhje, Hillary Clinton, gjithashtu pranoi humbjen të

nesërmen e votimit. Zëdhënësi i Putinit, Dmitry Peskov, u tha gazetarëve të hënën se ky vit është ndryshe. “Padyshim, ju mund të shihni se disa procedura ligjore po ndodhin atje, të cilat u njoftuan nga presidenti në detyrë, prandaj kjo situatë është e ndryshme, kështu që ne e konsiderojmë të saktë të presim për njoftimin zyrtar”, tha ai. Udhëheqësit e Kinës, Brazilit dhe Turqisë gjithashtu po i përmbahen urimit. Presidenti mexikan Andres Manuel Lopez Obrador tha se ai do të priste derisa të zgjidheshin sfidat ligjore mbi votimin. Zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme kineze, Wang Wenbin, të hënën ofroi një shpjegim të ngjashëm pse presidenti Xi Jinping ka qëndruar në heshtje. “Ne e kuptojmë se rezultati i zgjedhjeve presidenciale do të përcaktohet duke ndjekur ligjet dhe procedurat në ShBA”, tha



ai. Më herët udhëheqësit e Izraelit dhe të Arabisë Saudite iu bashkuan udhëheqësve të tjerë botërorë që uruan presidentin e zgjedhur të Shteteve të Bashkuara, Joe Biden. Megjithatë, në urimin e Netanyahu, një aleat i ngushtë

i Trumpit, është vërejtur mungesa e fjalëve “president i zgjedhur” dhe “zëvendës-presidente e zgjedhur”. “Unë do të doja të filloja me përshëndetjet për Joe Bidenin dhe Kamala Harrisin. Për gati 40 vjet kam pasur një marrëdhënie personale, të

gjatë dhe të ngrohtë me Joe Bidenin dhe e njoh atë si një mik të madh të shtetit të Izraelit”, tha ai në një deklaratë përmes videos. Netanyahu, gjithashtu, e falënderoi Trumpin për disa lëvizje që, sipas tij, kanë çuar përpara interesat e Izraelit.

Zhvillimet aktuale në vend, fillon bashkëpunimi institucional dhe partiak

Pas zhvillimeve të fundit në vend, konkretisht konfirmimit të aktakuzave nga Gjykata Speciale për ish-presidentin Hashim Thaçi, ish-kryetarët e Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli e Jakup Krasniqi, dhe deputetit Rexhep Selimi, ushtruesja e detyrës së presidentit, Vjosa Osmani dhe kryeministri Avdullah Hoti, kanë zhvilluar të hënën një takim në vazhden e koordinimit dhe bashkërendimit ndër-institucional. Po ashtu, edhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka zhvilluar një takim me përfaqësues të PDK-së dhe Nismës Socialdemokrate



HARADINAJ U SHKON PËR VIZITË PDK-SË DHE NISMËS

Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, të hënën është takuar me përfaqësues të PDK-në dhe të Nismës Socialdemokrate. Haradinaj

ka folur para mediave pas vizitës që ka pasur në PDK. Ai ka thënë se ishte në PDK-së për t'i dhënë mbështetje kësaj partie pas zhvillimeve nga Gjykata Speciale. "Qëllimi ishte të shprehet një përkrahje në këto rrethana të reja në zhvillimet që po ndodhin me aktakuzat. Sot është dita e paraqitjes së parë të udhëheqësve të UÇK-së. Në gara politike kemi pasur

gjithmonë mospajtime, por kam qenë në UÇK. Ramush Haradinaj është UÇK. Jam sot dhe do të jem gjithë jetën me të gjithë që kanë qenë ushtarë. Kjo është një përkrahje. Ata që mendojnë që e gjunjëzojnë mënyrën e lirisë, gabojnë çdoherë", ka thënë ai.

Haradinaj ka mohuar se ka qenë një takim ku është folur për zgjedhje ose për çështjen e presidentit. "E thashë edhe një herë, agjenda politike e partive vazhdon, qëllimi është që vetëm nëse Serbia e mban mend betejën e Kosovës, edhe na e mbajmë mend që mijëra vjet jemi në këtë vend. Kosova është e shqiptarëve", ka thënë Haradinaj.

Zëdhënësi i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Avni Bytyçi, ka konfirmuar se gjatë kësaj vizite nuk është biseduar për asnjë temë politike aktuale në Kosovë. "Z. Haradinaj ka vizituar sot, pa paralajmërim, zyrat e PDK-së, për ta shprehur solidarizimin për zhvillimet e fundit me Dhomat e Specializuara. Ne e falënderojmë për një gjest të tillë, ndërherësh konfirmojmë se nuk është folur për asnjë temë politike aktuale në Kosovë. Konfirmimi i aktakuzës ndaj ish-kryetarit Veseli dhe ish-presidentit Thaçi paraqet një situatë të rëndë për Kosovën dhe për PDK-në. Neve si shoqëri na duhet më së shumti sot solidarizimi dhe bashkëpunimi për ta tejkaluar këtë çast të vështirë për vendin", ka shkruar Bytyçi në llogarinë e vet në "Facebook".

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 9 NËNTOR - Ushtruesja e detyrës së presidentit, Vjosa Osmani, dhe kryeministri Avdullah Hoti kanë zhvilluar të hënën një takim për të diskutuar rreth zhvillimeve aktuale në këtë vend, pas dorëheqjes së Hashim Thaçit nga detyra e presidentit. Zyra e Presidencës ka njoftuar se takimi është mbajtur në vazhden e koordinimit dhe bashkërendimit ndër-institucional. "Në takim janë diskutuar aspekte të përgjithshme të funksionimit në vend. Kryeministri Hoti e ka njoftuar u. d. presidenten Osmani për hapat e ndërmarrë për menaxhimin e pandemisë, për dialogun me Serbinë, për aspekte të politikës së jashtme si dhe për çështje të sigurisë. Ndërkaq u. d. presidentja Osmani ka shtruar nevojën e koordinimit institucional në përballje me pandeminë Covid-

19, në këtë situatë të vështirë, në mënyrë që të zvogëlohen pasojat në njerëz nga kjo pandemi", ka njoftuar Presidenca.

Pas takimit, kryeministri Hoti ka deklaruar para gazetarëve se në këtë situatë në të cilën po kalon vendi, nevojitet unitet politik. "Pavarësisht prej zhvillimeve politike e proceseve në të cilat kalon vendi, si rezultat i dorëheqjes së presidentit të vendit, tash forcat politike duhet të bëhen bashkë që ta japin mesazhin e maturisë së institucioneve të Kosovës për t'iu dalë në ndihmë qytetarëve të Kosovës me pandeminë dhe me problemet ekonomike që vijnë si rezultat i pandemisë", ka deklaruar Hoti.

Më 5 nëntor Hashim Thaçi ka dhënë dorëheqje nga posti i presidentit të Kosovës për shkak të konfirmimit të aktakuzës për krime lufte nga Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë.

Të mërkurën seanca për shqyrtimin e dytë të Projektligjit për rimëkëmbjen ekonomike

PRISHTINË, 9 NËNTOR (ER) - Kryesia e Kuvendit të Kosovës ka vendosur që të mërkurën, më 11 nëntor, në orën 11:00, Kuvendi të mbajë seancën e jashtëzakonshme, për shqyrtimin e dytë të Projektligjit për rimëkëmbjen ekonomike - Covid-19, ndërsa në orën 12:00, në të njëjtën ditë, të vazhdojë seancën me pikat e papërfunduara nga seancat e kaluara. Të enjten, më 12 nëntor, ndërkaq, do të mbahet seancë e re, duke filluar në orën 10:00. "Seanca e rregullt do të fillojë me deklarime jashtë rendit të ditës dhe pyetje parlamentare, për të vazhduar me dy interpelanca të kryeministrit Avdullah Hoti: interpelancën për çështjen "Përfshirja dhe ndarja e liqenit të Ujmanit me Serbinë në dokumentin e zotimeve të 4 shtatorit 2020", sipas kërkesës së deputetit Liburn Aliu,

mbështetur edhe nga 6 deputetë të GP të LV-së, si dhe atë për çështjen "Trajtimi i dëmshëm i temës së të pagjeturve në zotimet e 4 shtatorit, duke e kushtëzuar me personat e zhvendosur", sipas kërkesës së deputetes Saranda Bogujevci, mbështetur edhe nga 6 deputetë të GP të LV-së", ka njoftuar Kuvendi.

Sipas këtij njoftimi, pas interpelancave, seanca do të fillojë me shqyrtimin e projektligjeve. Kështu, në lexim të parë pritet të shqyrtohen pesë sosh: Projektligji për të Drejtën Ndërkombëtare Private, Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Ekonomiko-Social, Projektligji për Inspektoratin e Punës, Projektligji për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara në transaksionet elektronike, si dhe Projektligji



për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.03/L-256. Pikë e rendit të ditës së kësaj seance do të jetë edhe shqyrtimi i raportit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin

2019, si dhe shqyrtimi i katër raporteve të katër institucioneve të pavarura për vitin 2019: Raportit Vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit, Raportit Vjetor të Komisionit Rregullator të Prokurimit Publik, Raportit Vjetor të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, si dhe

Raportit Vjetor të performancës së Zyrës Kombëtare të Auditimit. Po ashtu do të shqyrtohen edhe rekomandimet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, për raportin e auditimit të Pasqyrave Vjetore Financiare të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për vitin 2019, si dhe do të formohet Komisioni Ad-Hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Mediave, nga radhët e komunitetit shqiptar.

Gjithashtu, të premtën, më 13 nëntor, Kuvendi do të mbledhet po ashtu në seancë të re, në interpelancën e kryeministrit të Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, sipas kërkesës së deputetit Rexhep Selimi, mbështetur edhe nga shtatë deputetë të GP të LV-së, në lidhje me shfuqizimin e Task-forcës antikorruption në Policinë e Kosovës.



HASHIM THAÇI DHE JAKUP KRASNIQI JANË PARAQITUR TË HËNËN PARA DHOMAVE TË SPECIALIZUARA NË HAGË

THAÇI DHE KRASNIQI PARA SPECIALES: AKUZAT JANË TË PAQËNDRUESHME



Krasniqi: Kurrë në jetën time në asnjë rast nuk i kam trajtuar njerëzit as kaq sa e si më trajtuat mua nga ndërtesa e burgut e deri në këtë ndërtesë

Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, janë deklaruar të pafajshëm për të gjitha pikat e aktakuzës për krime luftime dhe krime kundër njerëzimit të ngritura nga Dhomat e Specializuara në Hagë. Gjatë paraqitjes së parë të tyre në Hagë, ata kanë deklaruar se ndihen të pafajshëm. Ndërsa avokatët e tyre kanë paralajmëruar se në javët në vijim do ta dorëzojnë kërkesën për lirimin e përkohshëm të tyre. Ndërsa avokati i Thaçit, David Hooper, e ka pyetur gjykatën se ku janë akuzat për vjedhje të organeve të njerëzve dhe e ashtuquajtura Shtëpi e Verdhë, që kanë qenë arsyet kryesore për themelimin e Gjykatës Speciale

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 9 NËNTOR - Ish-drejtori politik i UÇK-së, Hashim Thaçi, dhe ish-zëdhënësi i UÇK-së, Jakup Krasniqi, kanë hedhur poshtë pretendimet e Dhomave të Specializuara për krime luftime ndaj tyre. Në paraqitjen e parë para këtyre dhomave në Hagë, Thaçi dhe Krasniqi kanë thënë se akuzat ndaj tyre janë të pabaza. "Deklarohem i pafajshëm për të gjitha pikat e akuzës", ka deklaruar Thaçi kur është pyetur nga gjykatësi i procedurës paraprake nëse ndihet i pafajshëm apo fajtor rreth aktakuzës për krime luftime dhe krime kundër njerëzimit. Ai e ka deklaruar se aktakuzat kundër tij janë të paqëndrueshme. Njëjtë është deklaruar edhe ish-zëdhënësi i UÇK-së, Jakup Krasniqi, i cili është paraqitur në seancë paraditen e së hënës. "Unë nuk ndihem fajtor e as përgjegjës për asnjë pikë që thuhet në aktakuzë dhe për asnjë gjë tjetër që thuhet në aktakuzë", ka deklaruar Krasniqi gjatë paraqitjes së parë para Dhomave të Specializuara, kur



është pyetur nëse deklarohet i pafajshëm apo fajtor për krimet që rëndojnë ndaj tij.

Krasniqi, para se të deklarohet për aktakuzën, mbajti një fjalim para gjykatës, ku ka deklaruar se është bërë një padrejtësi e madhe ndaj tij. "Cilësimi i prokurorit të Dhomave të Specializuara, se ne qenkemi ndërmarrje kriminale e përbashkët, për mua, shokët e mi, familjen time që luftuam gjatë, por edhe për kombin tonë, nuk ka diçka më fyese, pasi ne një kohë të gjatë, në rrethana tepër të vështira jetë a vdekje, u vumë në shërbim të lirisë e të shtetndërtimit të cilat i arritëm në bashkëveprim me Shtetet e Bashkuara, me vendet e Bashkimit Evropian, me NATO-n, me OKB-në dhe të gjithë së bashku ishim dhe jemi ndërmarrje e përbashkët çlirimtare dhe shtetformuese", ka deklaruar Krasniqi gjatë një fjalimi para Gjykatës në Hagë. Ai ka vlerësuar se ndërmarrje e përbashkët kriminale është koka e Beogradit dhe mbështetësit e politikës së Beogradit.

Ai e ka kritikuar Specialen, duke thënë se në aktakuzat e saj po i ndan qytetarët e Kosovës në katolikë e myslimanë. "Ju në aktakuzë po mundoheni t'i ndani njerëzit në katolikë e myslimanë. Unë nuk jam as mysliman e as katolik. Jam shqiptar", ka thënë ai.

Krasniqi është ankuar edhe për trajtimin që po i bëhet nga Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar. "Unë jam arrestuar më 4 nëntor. Në aktakuzë po na quani ndërmarrje kriminale e përbashkët. Unë dua të deklaroj sot se kurrë në jetën time në asnjë rast nuk i kam trajtuar njerëzit as kaq sa e si më trajtuat mua nga ndërtesa e burgut e deri në këtë ndërtesë", ka deklaruar Krasniqi, duke shtuar se ndaj tij po bëhet



padrejtësi. "Mua më është bërë padrejtësi e madhe dhe do ta mbaj këtë padrejtësi. Unë dhe populli im kemi mbajtur shumë padrejtësi dhe nuk kemi pasur nevojë për këtë padrejtësi", është shprehur Krasniqi.

Pala mbrojtëse e Krasniqit ka paralajmëruar se shumë shpejt do të bëjë kërkesë për lirimin me kusht të Krasniqit. "Kemi synim të bëjmë një depozitim për lirimin paraprak ose me

kusht të tij sa më shpejt që të jetë e mundur", është shprehur avokatja Venkateswari Alagenda.

Veprat që rëndojnë ndaj Thaçit dhe Krasniqit kanë të bëjnë me krime lufte, ndalim të paligjshëm ose arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje e paligjshme dhe krime kundër njerëzimit, të burgosjes, të akteve të tjera çnjerëzore, torturë, vrasje e paligjshme, zhdukje me forcë të personave

dhe përndjekje, të cilat, sipas Dhomave të Specializuara, janë kryer midis marsit 1998 dhe shtatorit të vitit 1999. Sipas aktakuzës, krimet dyshohet se janë kryer në disa lokacione të Kosovës, por edhe në Kukës dhe Cahan në Shqipërinë Veriore.

Mbrojtja e Thaçit: Ku janë akuzat për vjedhje organesh?

Avokati i ish-presidentit Thaçi, David Hooper, e ka pyetur gjykatën në Hagë se ku janë akuzat për vjedhje të organeve dhe për të ashtuquajturën Shtëpi e Verdhë që, sipas tij, janë "njollë mbi Kosovën dhe kosovarët". "Ku janë këto pretendime për vjedhjen e organeve njerëzore dhe ku është historia e Shtëpisë së Verdhë e cila ishte e rëndësishme për krijimin e kësaj gjykate?", ka thënë Hooper, duke shtuar se asnjë nga këto pretendime nuk përmenden në aktakuzën e konfirmuar ndaj Thaçit. "Këto pretendime Thaçi i dinte se ishin gjepura. Ai e ndihmoi Komisionin Evropian për krijimin e kësaj gjykate", ka deklaruar ai.

Gjithashtu, avokati i ka



"Ku janë këto pretendime për vjedhjen e organeve njerëzore dhe ku është historia e Shtëpisë së Verdhë e cila ishte e rëndësishme për krijimin e kësaj gjykate?", ka thënë Hooper

Hoxhaj për paraqitjen e Thaçit në Speciale: Filloi një proces gjyqësor kundër lirisë së Kosovës

Ushtruesi i detyrës së kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës, Enver Hoxhaj, ka komentuar paraqitjen e ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, në Gjykatën Speciale, të cilën e ka cilësuar dinjitoze. Në profilin e vet në "Facebook", ai ka shkruar se kjo paraqitje është vazhdim i përpjekjeve të tij për forcimin e lirisë dhe pavarësisë së Kosovës. "Në Hagë sot nuk filloi një proces kundër Hashim Thaçit, por një proces gjyqësor kundër lirisë së Kosovës, pavarësisë, sakrificës së popullit tonë

dhe luftës çlirimtare. Lufta jonë mbrojtëse u bë nga populli i Kosovës. Atje po gjykohej populli i Kosovës. Hashim Thaçi deri më sot iu ka prirë betejave. Asaj për liri, asaj për pavarësi, asaj për shtetndërtim. Kjo është beteja e radhës dhe jo e fundit që Hashim Thaçi do t'i prijë për të dalë sërish fitues. Për të dalë fituese Kosova! Prandaj, paraqitja dinjitoze e presidentit Thaçi në Dhomat e Specializuara për Kosovën është vazhdim i përpjekjeve të tij për forcimin e lirisë dhe pavarësisë së Kosovës", ka shkruar Hoxhaj.

kritikuar Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar që nuk kanë simbole të Kosovës, ndonëse janë krijuar nga Prishtina zyrtare. Avokati David Hooper ka thënë se do të kërkojnë lirim të përkohshëm për ish-presidentin Hashim Thaçi. Ai ka shtuar se kërkesa për lirim të përkohshëm do të bëhet në javët e ardhshme. "Unë mund ta paraqes këtu Thaçin njëri me dinjitet dhe ndershmëri, njeri që i ka shërbyer vendit në liri dhe paqe, burrë që ka arritur shumë dhe nuk i meriton këto pretendime", ka thënë ai, duke shtuar se Thaçi ishte zëri i arsyes gjatë luftës. "Thaçi doli mbi luftën e UÇK-së si zëri i arsyes, duke shtuar se ishte pikërisht ai personi që çoi vendin drejt pavarësisë", ka thënë Hooper duke e cituar ish-senatorin amerikan Bob Dole për

Thaçin. Më pas, ai ka përmendur edhe vlerësimin e Joe Bidenit për Thaçin. "Ish-zëvendëspresidenti Joe Biden, tash president i zgjedhur i ShBA-së, e ka quajtur z. Thaçi George Washingtoni i Kosovës", ka thënë Hooper.

Avokati Hooper ngriti edhe çështjen e vendosjes së prangave ndaj Thaçit, duke thënë se kjo është turp. "Nuk jeni organ ndëshkimi. Nuk besoj se jeni kështu. Shpresoj të jetë kështu. Mos ulni integritetin e personit deri në atë pikë", ka deklaruar ai.

Ndërkaq, gjykatësi i procedurës paraprake ka thënë se nuk ka trajtim të posaçëm për Thaçin sa iu përket prangave. "Sa iu përket prangave, nuk ka trajtim të posaçëm për klientin tuaj, është procedurë që aplikojmë për çdo person që vjen në sallën e gjyqit", ka thënë ai.

Ish-udhëheqësit e UÇPMB-së: Lufta e UÇK-së ka qenë e pastër

PRISHTINË, 9 NËNTOR (ER) - Ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, ka pritur të hënën në takim ish-udhëheqësit ushtarakë dhe politikë bashkë me luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare për Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc (UÇPMB), me të cilët ka diskutuar për situatën e fundit të krijuar pas konfirmimit të aktakuzave për ish-ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK).

Pas takimit, në një konferencë për media, ministri Selimi ka thënë se beson në drejtësinë dhe pastërtinë e luftës së UÇK-

së. "Kjo konferencë për shtyp është me shkas pasi që sot kam pritur ish-udhëheqësi e luftës së UÇPMB-së, komandantë, ushtarë dhe eprorë të kësaj ushtrie. Ne jemi mbledhur sot për të dërguar një mesazh që: thelbi i UÇPMB-së është lufta e UÇK-së dhe për këtë shkak jemi mbledhur këtu sepse ne besojmë në drejtësinë dhe besojmë në pastërtinë e luftës së UÇK-së", ka deklaruar ministri Selimi. Ai ka thënë se të gjithë ushtarët e UÇK-së që po ballafaqohen me drejtësi nuk janë vetëm, por e kanë edhe UÇPMB-në mbra-



pa për mbrojtjen e pastërtisë dhe vlerave.

Ndërsa ish-përfaqësuesi politik i Shtabit të Përgjithshëm të UÇPMB-së, Shaqir Shaqiri, ka

thënë se lufta e UÇK-së dhe UÇPMB-së ka qenë e pastër dhe ka pasur qëllim lirinë për popullin shqiptar. Shaqiri, ndër tjera, tha se

mbështesin bashkëluftëtarët dhe drejtuesit e UÇK-së të cilët po kalojnë në procese gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara në Hagë. "Edhe këto procese që tanimë janë ngritur, kinse që për të hulumtuar, dëshmuar apo për të parë nëse lufta e UÇK-së ka qenë luftë e pastër, ne i kemi mbështetur, por si luftëtarë të lirisë jemi të zhgënjyer sepse një gjykatë e cila ngrehet mbi thashetheme nuk mund të jetë gjykatë e drejtë dhe mund të jetë gjykatë separatiste, që gjykon njëanshëm", ka thënë Shaqiri.

Kosova ua njohu katër qytetarëve statusin e personave pa shtetësi

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 9 NËNTOR - Ministria e Punëve të Brendshme, në bashkëpunim me Agjencinë e Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR), organizuan ceremoninë për njohjen e statusit të personave pa shtetësi. Në këtë ceremoni morën pjesë drejtori i Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migracion, Valon Krasniqi, shefi i Divizionit për Shtetësi, Liridon Neziri, si dhe shefi i misionit të UNHCR-së në Kosovë, Erol Arduc dhe Merita Ahma, zyrtare e lartë në UNHCR.

Drejtori i Departamentit për Shtetësi dhe shefi i misionit të UNHCR-së vlerësuan përpjekjet që ka bërë shteti i Kosovës për plotësimin e legjislacionit, për t'i përfshirë edhe kategoritë pa shtetësi, si pjesë me të drejta të barabarta si çdo qytetar.

MPB-ja në bashkëpunim me UNHCR-në kanë bërë përpjeke prej shumë viteve që t'u garantohet e drejta për shtetësi qytetarëve që kanë qenë duke qëndruar në Kosovë dhe që nuk pasur shtetësi të asnjë vendi.

Republika e Kosovës është zotuar përmes legjislacionit që nga viti 2014, që në përputhje me konventën e vitit 1954, t'i trajtojë rastet e personave pa shtetësi, si një kategori e veçantë juridike dhe është zotuar që do t'u ofrojë çdo lehtësi sa i përket integritetit të tyre në shoqëri.

Duke marrë parasysh këto zotime, të hënën në një ceremoni të veçantë iu është njohur statusi i personit pa shtetësi katër qytetarëve. Me këtë hap Republika e Kosovës ka hapur një kapitull të ri sa i përket përmbushjes së obligimeve karshi të drejtave themelore të njeriut në raport me obligimet ndërkombëtare.



Apeli vërteton aktgjykimin lirues ndaj Sami Lushtakut dhe të tjerëve në rastin "KEK"-u

PRISHTINË, 9 NËNTOR (ER) - Gjykata e Apelit ka vërtetuar aktgjykimin lirues ndaj Sami Lushtakut dhe të tjerëve në rastin "KEK"-u, duke e refuzuar ankesën e Prokurorisë Speciale. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Prishtinës, i datës 9 gusht të këtij viti, është thënë nga Apeli se është vërtetuar, përpos te rasti i Esat Tahirit dhe Milazim Lushtakut, ku janë liruar për shkak të veprës penale "Falsifikim i dokumenteve zyrtare në bashkëkryerje". "Aktgjykimi i ankimuar në këtë pjesë është ndryshuar, ashtu që aktakuza e prokurorisë është refuzuar për shkak të parashkrimit të veprës penale", thuhet nga Apeli.

Ish-kryetari i Skenderajt, Sami Lushtaku dhe persona të tjerë të akuzuar në rastin "KEK-u", ishin shpallur të pafajshëm nga Gjykata Themelore. Në këtë rast gjyqësor Esat Tahiri dhe Milazim Lushtaku u akuzuan "për veprën



penale mashtrim". Ndërkaq ish-drejtori i prokurimit, Driton Pruthi, drejtori i KEK-ut, Arben

Gjukaj dhe ish-kreu i OShP-së, Hysni Hoxha, u akuzuan "për keqpërdorim të pozitës ose

autorizimit zyrtar", ndërsa kryetari i Skenderajt, Sami Lushtaku, u akuzua "për shtytje në keqpërdorim të detyrës zyrtare".

Prokuroria pretendonte se sjellja e paligjshme e të pandehurve ka rezultuar me dhënien e kontratës kompanisë së sigurimit "Security Code", e cila ka ofertuar si pjesë e konsorciumit me kompaninë "WDG". Kontrata në fjalë ishte për periudhën dyvjeçare, në shumën prej 6.182.609,76 eurosh, për të cilën pretendohet se është dëmtuar KEK-u. Pronar i kompanisë që pati fituar tenderin është Milazim Lushtaku, kushëri i Sami Lushtakut, i cili, po ashtu, është liruar nga akuzat. "Gjykata Themelore në Prishtinë në janar të këtij viti kishte nxjerrë një aktgjykim lirues dhe refuzues për të akuzuarit E. T. dhe M. L. për shkak të veprës penale 'Falsifikim i dokumenteve

zyrtare në bashkëkryerje'. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë me të njëjtin aktgjykim kishte liruar nga akuzat: të akuzuarin D. P. për shkak të veprës penale 'Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar' dhe 'Lidhje të kontratës së dëmshme', të akuzuarin A. Gj. për shkak të veprës penale 'Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar', të akuzuarin H. H., gjithashtu për shkak të veprës penale 'Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar', të akuzuarin A. D. për shkak të veprës penale 'Shtytje në kryerjen e veprës penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar', njësoj si të akuzuarit E. T. dhe S. L. Gjykata e Apelit gjeti se gjykata e shkallës së parë, nga provat e administruara, drejt ka konstatuar se nuk janë konsumuar elementet e veprës penale për të cilat të akuzuarit janë ngarkuar, thuhet në komunikatën e Apelit.

KFOR-i mbështet OJQ-në që ndihmon personat me aftësi të kufizuara

PRISHTINË, 9 NËNTOR (ER) - Ushtarët e Komandës Rajonale të KFOR-it - Lindje, i dorëzuan të hënën sisteme të ajrit të kondicionuar Organizatës Joqeveritare Handikos, e cila ofron shërbime fizioterapeutike dhe trajtime të tjera për personat me aftësi të kufizuara. Handikosi përmes projekteve të ndryshme vitin e kaluar mbështeti 78 fëmijë dhe 97 të rritur në rajonin e Prishtinës

nga të gjitha grupet etnike. Drejtorit i Qendrës Handikos në Drenas, Behxhet Binaku, ka falënderuar kolonelin Noel Hoback për donacionin që do t'i përmirësojë kushtet e punës së operatorëve dhe do të sjellë përfitime për aktivitetet lokale të OJQ-së. Pajisjet u financuan nga NATO-ja në kuadër të ndihmës së paanshme të KFOR-i. Donacioni u dorëzua nga

personeli për bashkëpunim civil-ushtarak të shtabit të përgjithshëm. KFOR-i po i mbështet institucionet dhe organizatat e përkushtuara për t'i ndihmuar qytetarët pa marrë parasysh etninë e tyre. Mbështetja e KFOR-it përqendrohet në fushat e arsimit dhe të shëndetësisë. Operacioni i udhëhequr nga NATO-ja po kontribuon në reagimin lokal ndaj Covid-19 përmes sigurimit të pajisjeve



të mbrojtjes personale dhe projekteve që ofrohen nga përmes lehtësimit të vendet aleate dhe partnere.

Zemaj paralajmëron masa të reja, Ahmeti thotë se Prishtina mund të mbyllet për një javë

Të hënën Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike në Kosovë ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit ka regjistruar edhe 637 raste me Covid-19. Rezultatet janë në bazë të 1 712 mostrave të testuara. Gjatë kësaj periudhe kanë vdekur edhe 13 pacientë. Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, në një takim me kryetarët e komunave ka paralajmëruar masa të reja kundër Covidit, ndërkaq kryetari i Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka theksuar se kryeqyteti mund të mbyllet për një javë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 9 NËNTOR - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe në laboratorët privatë janë testuar gjithsej 1 712 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 637 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve janë raportuar 13 raste të vdekjes me Covid-19. Rastet e vdekjes janë nga komunat: Ferizaj tri raste (81, 74 dhe 70 vjeç), Prizren dy raste (71 dhe 65 vjeç), Fushë-Kosovë një rast (54 vjeç), Gjakovë një rast (81 vjeç), Istog një rast (65 vjeç), Lipjan një rast (73 vjeç), Pejë një rast (46 vjeç), Prishtinë një rast (65 vjeç), Suharekë një rast (85 vjeç) dhe Vushtrri një rast (70 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 24 792 raste nga 108 482 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 768 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 104 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 16 226 raste, ndërsa numri i rasteve aktive është 7 798.

Rastet e fundit pozitive janë nga: Komuna Prishtinë 324 raste, Komuna Gjilan 66 raste, Komuna Ferizaj 50 raste, Komuna Fushë-Kosovë 43 raste, Komuna Mitrovicë 25 raste, Komuna Podujevë 22 raste, Komuna Vushtrri 20 raste, Komuna Lipjan 15 raste, Komuna Prizren 12 raste, Komuna Obiliq 8 raste, Komuna Kamenicë 6 raste, Komuna Pejë 6 raste, Komuna Suharekë 6 raste, Komuna Rahovec 5 raste, Komuna Shtime 5 raste, Komuna Viti 4 raste, Komuna Drenas 3 raste, Komuna Gjakovë 3 raste, Komuna Kaçanik 3 raste, Komuna Malishevë 3 raste, Komuna Hani i Elezit 2 raste dhe me nga një rast Komunitat Dragash, Junik, Klinë, Mamushë, Novobërdë dhe Skenderaj.

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka zhvilluar të hënën një takim me kryetarët e komunave, me të cilët ka diskutuar për hapat që duhen ndërmarrë për frenimin e përhapjes së Covidit. Zemaj ka thënë se laborja e rasteve të fundit kërkon kujdes të shtuar dhe aktiv. "Në takimin virtual me kryetarët e komunave biseduam për shqetësimet në ditët e fundit dhe situatën epidemiologjike, si dhe për koordinimin e mëtejshëm për respektimin e masave kundër virusit Covid-19. Nga java e

kaluar kemi filluar masat më të rrepta për disa qytete të Kosovës dhe do të vazhdojmë çdo ditë, me vendime operacionale, për komuna të caktuara në bazë të kategorizimit si pasojë e numrit të të infektuarve. Laborja e rasteve të fundit na detyron për kujdes të shtuar dhe aktiv", ka thënë ai.

Ministri Zemaj ka kërkuar bashkëpunim të ngushtë me komunat e Kosovës, me theks me kryetarët dhe shtabet komunale emergjente dhe, po ashtu, bashkëpunimi i të gjithë mekanizmave të institucioneve qendrore dhe lokale për zbatim rigoroz të masave të dala nga niveli qendror, është i domosdoshëm. "Kërkesat dhe rekomandimet do të jenë në funksion të luftës efikase kundër virusit Covid-19", ka thënë Zemaj.

Në anën tjetër, kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, në një shkrim publikuar në "Facebook" ka shkruar se

niveli qendror e ka vendosur Prishtinën në zonën e kuqe, duke rekomanduar mbyllje të qytetarëve për një javë. "Si arsyetim ka përdorur numrin aktiv të të infektuarve. Duke marrë parasysh që Prishtina pakrahasimisht ka numrin më të madh të testeve dhe, po ashtu, numrin më të madh të banorëve ne kemi kërkuar që kjo matje të bëhet me numrin e rasteve pozitive si përqindje e testeve. Por, kjo nuk është marrë parasysh", ka shkruar Ahmeti. Në fundjavën që shkoi në Kosovë ka qenë e ndaluar veprimtaria e të gjitha subjekteve afariste dhe bizneseve me qëllim të frenimit të përhapjes së Covid-19. Në këtë periudhë janë mbyllur edhe qendrat tregtare dhe rekreative dhe subjektet që ofrojnë shërbime të gastronomisë në të gjithë territorin e Kosovës. Në fundjavë, po ashtu, qytetarëve të shtatë komunave të Kosovës: Prishtinë, Fushë-Kosovë, Gjilan, Obiliq, Gjakovë, Podujevë dhe Shtime u janë ndaluar hyrjet dhe daljet, përveç në disa raste të domosdoshme.

Shoqata e Gastronomëve e Kosovës dhe Oda Ekonomike e Kosovës kundërshtuan çdo vendim për mbyllje të mëtutjeshme të bizneseve nëse ato nuk subvencionohen dhe mbështeten me pako strategjike për mbulimin e dëmeve. Shoqata e Gastronomëve e Kosovës, në një mbledhje të jashtëzakonshme, kërkoi nga institucionet që të mos marrin vendime që i dëmtojnë bizneset. "Në rast se vendimet e ardhshme për mbyllje nuk do të subvencionohen apo

mbështeten me plane konkrete strategjike për mbulimin e dëmeve dhe pako për subvencionim të linjave të pagave të punëtorëve, subvencionim të shpenzimeve të qirasë, ndihmesë në pagesën e interesave të kredive, ndarjen e granteve që stimulojnë qarkullimin në gastronomi, zotohemi se do ta kundërshtojmë çdo vendim për mbyllje të mëtutjeshme ose shkurtim orari, në çdo formë të mundshme, përfshirë edhe ato radikale: mosmbylljen e lokaleve apo edhe protesta", thuhet në një komunikatë të gastronomëve të Kosovës.

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, në një shkrim publikuar në "Facebook", ka theksuar se kjo javë është vendimtare për "mosdërgimin e ekonomisë në kolaps". "Për rimëkëmbje as nuk diskutohet. Tani para rimëkëmbjes duhet të sigurohet mbijetesë", ka shkruar Rukiqi.

Raportit i Rregullt Ekonomik i Bankës Botërore, i publikuar më 22 tetor, ka veçuar se pandemia Covid-19 i kërcënon vendet e punës në Kosovë. Sipas këtij raporti, ekonomia e Kosovës pritet të tkurret 8.8 për qind në vitin 2020. Bizneset në Kosovë, për t'i mbajtur punëtorët në punë dhe për t'i rikuperuar humbjet nga pandemia, janë ndihmuar nga Fondi për Rimëkëmbje Ekonomike i Qeverisë së Kosovës. Për këto biznese, nga ky Fond që kap vlerën e mbi 350 milionë eurove, janë ndarë së voni 60 milionë euro, por ato janë vlerësuar si të pamjaftueshme nga vetë bizneset.



Reagim i KMDLNj-së

Mbyllja e bizneseve pa miratim të programit për rimëkëmbje ekonomike, hap drejt anarkisë dhe falimentimit!

Qeveria e Kosovës, përkatësisht Ministria e Shëndetësisë, në përpjekje për ta luftuar pandeminë e shkaktuar nga Covid-19, e bëri një mbyllje "kreative" për shtatë qytete në Kosovë duke i futur në një karantinë të pjesshme dhe duke caktuar orarin dhe profilin e bizneseve që lejohet të punojnë gjatë këtij karantinimi. Realisht, numri i të infektuarve dhe të vdekurve në Kosovë është rritur shumë, por nuk dallon aspak nga trendet në vendet e tjera. KMDLNj edhe më herët ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës të ndërmarrë disa masa kufizuese për ta mbajtur nën kontroll apo parandaluar eskalimin e situatës, gjithnjë duke marrë parasysh interesin e qytetarëve. Mbyllja e shtatë qyteteve në Kosovë jo që nuk e arriti qëllimin e prituri, por e pati efektin e kundërt si për rritjen e të infektuarve, po ashtu edhe të viktimave. Madje në raportin e së dielës del se numri i të infektuarve ishte mbi 700 e që, nëse krahasohet me numrin e të testuarve, del se 50 për qind e të testuarve kanë dalë pozitiv. Raporti i sotëm do ta pasqyrojë efektin definitiv të karantinimit të shtatë qyteteve në Kosovë e që do të duhej t'i shërbejë vendimmarrësve për hapat që duhet të ndërmerren në të ardhmen.

Gastronomët, që u dëmtuan më së shumti, protestuan kundër

masave të Qeverisë së Kosovës dhe për këtë përfaqësuesit e tyre u dënuan me nga 500 euro gjobë e që për KMDLNj-në, aq sa është i padrejtë, është edhe kundër çdo logjike, aq më parë që Qeveria e Kosovës nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për t'i ndihmuar bizneset e rrënuara apo që janë në prag të rrënimit. Mjetet nga Pakoja Emergjente, që kohë më parë ishin ndarë nga Qeveria e Kosovës, KMDLNj-ja i konsideron si mjete paliative apo intervenime që u jepen atyre që janë buzë vdekjes jo për t'i shpëtuar, por për t'ua zvogëluar dhembjet para vdekjes së pashmangshme. Sepse, t'i mbyllësh bizneset, cilado qofshin ato e që paguajnë tatim, pa i përkrahur ato, në fakt është kontribut për falimentimin e tyre, me shumë vende pune të humbura, kriza ekonomike dhe tensione sociale e që pashmangshëm do dhe duhet të çojnë në protesta që duhet të përkrahen nga të gjithë. Mbi të gjitha, është shkelje e të drejtave të njeriut, e drejta për punë, në radhë të parë. Për KMDLNj-në është krejtësisht e pamoralshme dhe e papranueshme që deputetët e Kuvendit të Kosovës nuk e votojnë programin për rimëkëmbje ekonomike, aq më parë që ata duhet ta përfaqësojnë dhe mbrojnë interesin e qytetarëve (votuesve) pavarësisht subjektit që e



përfaqësojnë. Të bëhen lojërë për përfitime politike në kohën kur pjesa dërrmuese e qytetarëve të Kosovës, në mënyrë galopante po shkonë drejt varfërimit të skajshëm, nuk ka të bëjë asgjë me moralin njerëzor, në radhë të parë, e pastaj atij politik aq më parë që pagat, shumë të shëndosha për deputetët, i marrin nga ata që po varfërohen dhe po bëjnë përpjekje jo për një jetë më të mirë, por për mbijetesë. Shteti duhet të sigurojë lehtësira për të gjitha bizneset në përpjekje për rimëkëmbjen e tyre sepse nga ato tatime edhe mbushet buxheti i Kosovës. Serbia, p. sh., deri më tani ka ndarë nga pesë paga për

të punësuarit, ndërsa Kosova ka ndarë vetëm nga dy paga sikur edhe të gjitha vendet e rajonit. Nga Pakoja Emergjente është dashur të përfitojnë të gjithë ata që janë tatimpagues të rregullt pavarësisht a janë biznese, media, OJQ apo ushtrinë ndonjë aktivitet tjetër. Pakoja Emergjente ka diskriminuar disa kategori të tatimpaguesve, padrejtësisht.

KMDLNj-ja e kundërshton çfarëdo kufizimi të bizneseve, pa asnjë dallim, nëse Qeveria e Kosovës nuk ofron kompensim të arsyeshëm për humbjet që i pëson biznesi gjatë mbylljes apo kufizimit. Deri më tani Qeveria e Kosovës nuk e ka bërë këtë dhe në

këtë mënyrë po bëhet varmihëse e shumicës së bizneseve sikur edhe për varfërimin e qytetarëve të Kosovës. Ndërkaq, sa iu përket parave të Trustit të Pensioneve, KMDLNj mendon se ato para janë të qytetarëve të Kosovës që i kanë kursyer e jo të Trustit dhe ata duhet të vendosin se sa para duan t'i tërheqin. Shuma e lejuar prej 10 përqindësh është diskriminuese aq më parë që për paratë e deponuara në Trust qytetarët nuk përfitojnë asgjë, madje as kamatat e ligjshme në ndërkohë që Trusti bën tregti me paratë e qytetarëve në tregjet ndërkombëtare, pa u pyetur fare pronarët e vërtetë e atyre parave e që janë qytetarët e Kosovës.

Nis fushata për përkujtimin e viktimave të trafikut rrugor

EPOKA E RE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 9 NËNTOR - Ministria e Infrastrukturës, bashkë me Policinë e Kosovës, Kolegjin "Tempulli" dhe Asociacionin Kosovar të Motorizimit "AMRKS", kanë nisur fushatën njëjavore për shënimin e "Ditës botërore për përkujtimin e viktimave në trafikun rrugor". Ministri i Infrastrukturës, Arban Abrashi, ka thënë se ky aktivitet ka karakter ndërkombëtar dhe realizohet në shumë vende të botës, duke besuar se me iniciativa të tilla do të ndikojnë më shumë në ngritjen e sigurisë në rrugë dhe në vetëdijesimin e qytetarëve. "Ne po fillojmë fushatën njëjavore që ka të bëjë me ditën e përkujtimin të viktimave të trafikut rrugor, por edhe t'i parandalojmë aksidentet. Jemi

duke punuar në shumë aspekte për ta ngritur sigurinë në komunikacion bashkë me shumë institucione të tjera, duke i dhënë rëndësi shpëtimit të jetëve. U bëj thirrje të gjithë pjesëmarrësve në komunikacion që të jenë të vëmendshëm dhe të kujdesshëm që të mos bëhen pjesë e statistikave të vdekjeve e të lëndimeve", ka thënë ministri Abrashi.

Ndërsa Jeton Rexhepi, drejtor i Divizionit të Komunikacionit Rrugor në Policinë e Kosovës, bëri me dije se ka rënie të të vdekurve nga aksidentet në komunikacion. "Mund të themi se ky vit karakterizohet me rënie të aksidenteve dhe rënie të numrit të aksidenteve që kanë humbur jetën", është shprehur Rexhepi.

Edhe Muhamed Krasniqi, drejtor i Kolegjit "Tempulli", ka



thënë se çdo 24 sekonda një person vdes nga aksidentet në komunikacion. Krasniqi ka kërkuar nga qytetarët që të jenë të kujdesshëm në komunikacion dhe ka kërkuar mbështetje për familjarët që kanë humbur më të dashurit e

tyre në aksidente. Për "Ditën botërore për përkujtimin e viktimave në trafikun rrugor" do të ketë një javë aktivitete nga Ministria e Infrastrukturës, Policia e Kosovës, Kolegji "Tempulli" dhe AMRKS-ja. Mesazhi kryesor i

tyre është një veturë e aksidentuar, e vënë në sheshin "Zahir Pajaziti", nëpërmjet të cilës bëhet thirrje për ngritje të vetëdijes te pjesëmarrësit në komunikacion, që të mos bëhen pjesë e statistikave të vdekjeve dhe lëndimeve.

Sekretri i financimit të partive politike



PRISHTINË, 9 NËNTOR - Rreth 3.7 milionë euro kanë shpenzuar gjashtë subjektet më të mëdha politike në Kosovë gjatë vitit të kaluar. Bëhet fjalë për Lëvizjen Vetëvendosje (LV-në), Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK-në), Partinë Demokratike të Kosovës (PDK-në), Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës (AAK-në), Nismën Socialdemokrate (NS-në) dhe Listën Serbe (LS-në). Kështu thuhet në raportet e tyre financiare të publikuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ-ja). Në bazë të raportit, PDK-ja ka shpenzuar më shumë se 1.3 milion euro, pasuar nga LDK-ja me 1.3 milion euro, Lëvizja Vetëvendosje 1.1 milion euro, AAK-ja 601 mijë euro, Nisma

Socialdemokrate 261 mijë euro të shpenzuara dhe 260 mijë euro Lista Serbe. Por, kjo vlerë dyshohet të jetë disa herë më e lartë, pasi partitë politike në Kosovë në raportet financiare kanë deklaruar vetëm shpenzimet e bazuara nga të hyrat e buxhetit të Kosovës, thotë Arton Demhasaj, drejtor i Organizatës për Demokraci, Anti-korrupsion dhe Dinjitet - Çohu.

Ai, në një bisedë për "Radion Evropa e Lirë", shprehet se partitë politike vazhdimisht i kanë mbajtur të fshehura fondet e siguruara dhe shumën e shpenzuar. "Kjo asnjëherë nuk pasqyron një gjendje reale të financimit të partive politike. Për shkak se partitë politike edhe me

ligji e kanë mundësinë të marrin donacione të jashtme nga ana e donatorëve të ndryshëm, qoftë biznese apo persona fizikë. Kurse pjesën më të madhe të këtyre donacioneve shpeshherë nuk e deklarojnë", thotë Demhasaj.

Partive politike, të cilat janë të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës, për një vit nga buxheti u ndahen më shumë se 4 milionë euro. Kjo ndarje bëhet në bazë të përfaqësimit të numrit të ulëseve të fituara në Kuvend për një mandat.

Gjatë vitit të kaluar, më 6 tetor, në Kosovë janë mbajtur zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Maksimumi i shpenzimeve për secilën parti ka qenë 986 mijë euro. Në bazë të Ligjit për

zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, subjektet politike që veprojnë në Kosovë nuk mund shpenzojnë më shumë para se 0.50 cent për votues. Përveç mjeteve që u ndahen nga buxheti i Kosovës, partitë politike financohen edhe nga bizneset private, e që në shumicën e rasteve nuk i paraqesin në raportet e tyre financiare, thotë Demhasaj. Në raportet e paaudituar financiare të partive politike të publikuara më 2 nëntor nga Komisioni Qendror Zgjedhor, përveç emrave në disa raste të anëtarëve të partive përkatëse dhe personave individualë, nuk figuron ndonjë biznes si financues. Mospublikimi i emrave të

kompanive private, thotë Demhasaj, bëhet me qëllime të caktuara nga partitë politike. "Partitë politike tashmë më tepër deklarojnë donacione nga personat individualë sesa nga bizneset për shkak se ato biznese më vonë po fitojnë tenderë publikë. Kjo bëhet me qëllim, në mënyrë që mos t'u zbulohet emri kompanive financuese. Këtu është pjesa më e madhe që partitë politike financohen në mënyrë të paligjshme", thekson ai.

Mostransparenca rreth të hyrave dhe shpenzimeve të partive politike do të jetë evidente deri në plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për financimin e subjekteve politike, thotë Allen Meta, hulumtues i projekteve në organizatën Demokracia për Zhvillim (D4D).

Në vitin 2019 Qeveria e atëhershme e Kosovës e kishte iniciuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për financimin e partive politike. Projektligji ka kaluar në leximin e parë në Kuvendin e Kosovës por, për shkak të ndryshimeve të propozuara nga partitë politike, ai ishte kundërshtuar nga shoqëria civile, me arsyetimin se projektligji nuk siguron transparencë në publikimin e financave dhe shpenzimeve të partive politike. Në qershor të vitit 2019 Qeveria e Kosovës e kishte tërhequr nga Kuvendi i Kosovës këtë projektligj.

Transparenca rreth financimit të partive politike ka qenë dhe mbetet një prej ngecjeve të vazhdueshme të Kosovës që është shënuar gati se në të gjitha raportet e progresit të Komisionit Evropian. Kurse në raportin e publikuar së fundmi, i është kushtuar rëndësi e veçantë vonesës së rishikimit të legjislacionit për financimin e partive politike.

Shtyhet protesta e punëtorëve të Telekomit, jepet edhe një javë kohë për dialog

PRISHTINË, 9 NËNTOR (ER) - Këshilli Organizativ i Protestave të FSP-PTK-së përmes një njoftimi për media ka bërë me dije se do t'u japë hapësirë negociatave sa iu përket zhvillimeve në Telekom pas bllokimit të xhirollogarive, duke përfshirë mundësinë e protestave. "Pas komunikimeve të vazhdueshme me kryeministrin Avdulla Hoti dhe ministrin Blerim Kuçi dhe premtimet që brenda dy apo tri ditëve do të zgjidhet përfundimisht kontesti mes 'Dardafon' dhe Telekomit të Kosovës, Këshilli i Grevave, për shkak të gjendjes së krijuar me Covid-19 dhe pas kërkesave që

t'i jepet hapësirë dialogut, ka pranuar që edhe kjo javë të jetë javë e negociatave përfundimtare për gjetjen e zgjidhjes së qëndrueshme për Telekomin e Kosovës. Këshilli i Grevave ka marrë vendim të prerë që, nëse dështojnë hapja e xhirollogarive dhe fillimi i operimit normal të ndërmarrjes gjatë kësaj jave, nga e hëna, datë 16.11.2020, nga ora 13:00, do të protestohet para Qeverisë së Republikës së Kosovës si dhe do të fillojë po ata ditë edhe greva e përgjithshme", thuhet në njoftimin për media të Këshillit Organizativ të Protestave të FSP-PTK-së.



Përfaqësuesit e komunave shqiptare në rajon diskutojnë për pandeminë

TIRANË, 9 NËNTOR (ER) - Është mbajtur në Tiranë mbledhja e asamblesë së përgjithshme e Unionit të Bashkive dhe Komunave Shqiptare në Rajon. Përfaqësues të komunave e anëtarë të unionit ishin pjesë e mbledhjes për ta shkëmbyer përvojën për planifikimin dhe zbatimin e punëve përgjatë periudhës së pandemisë. Në këtë mbledhje, përfaqësues nga Komuna e Prishtinës kanë kontribuar në diskutim, duke ndarë përvojën, praktikat e mira dhe

sfidat në menaxhimin e pandemisë Covid-19, si dhe hartimin e strategjisë për zhvillimin e turizmit në kryeqytet. "Prishtina tashmë e ka edhe brendin turistik, modeli i të cilit mund të përdoret edhe në Union. Ngritja e kapaciteteve dhe strukturat rajonale do të na ndihmojnë që më lehtë të përballemi me sfidat dhe pasojat e pandemisë Covid-19. Bashkë për t'u ringritur më të fortë!", ka njoftuar Komuna e Prishtinës.



Peja dhe Gucia, ofertë të përbashkët për turizmin kulturor

Pejë, 9 nëntor (ER) - Komuna e Pejës dhe Komuna e Gucisë, pas binjakëzimit të këtyre dy komunave, kanë bashkuar forcat e tyre për një bashkëpunim më të afërt, duke hartuar projektin e përbashkët "Trashëgimia kulturore - thesar i rajonit ndërkuftar", e cila prek temën e turizmit kulturor.

Ky projekt është përkrahur nga fondet e "EU-Programi për bashkëpunim ndërkuftar në mes të Malit të Zi dhe Kosovës", të cilët do të financojnë 85 për qind të projektit, ndërsa pjesa tjetër do të jetë bashkëfinansim nga dy komunat dhe do të zgjasë 24 muaj. Projekti ka të bëjë me diversifikimin e trashëgimisë kulturore dhe zhvillimin e ofertave turistike kulturore, që përfshin këto dy komuna.

Ndër të tjera, kryetari i Komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri, ka theksuar se ky është një projekt i cili ka vënë hapat e para të bashkëpunimit më të afërt në mes të këtyre dy komunave. Sipas tij, në të ardhmenë presin ta



vazhdojnë edhe më tepër këtë bashkëpunim duke i diversifikuar potencialet natyrore dhe kulturore. "Këto potenciale do t'i paraqesim si një destinacion unik përgjatë shtegut të ecjes Majat e Ballkanit, apo Via Dinarica për përvojat e çdo vizitori. Njëherësh ky projekt do ta ketë edhe aspektin ekonomik duke ndikuar drejtpërdrejt në ngritjen e numrit të vizitave në këto vende, për diversifikimin e ofertës turistike, të cilat mund të ofrohen si përvoja të reja nga

tour operatorët dhe për punësim të guidave të reja kulturore, qëndrim më të gjatë të vizitorëve në destinacion dhe mundësi që të gjitha shërbimet t'i ngrehin të hyrat e tyre", ka deklaruar Muhaxheri.

Ndërsa kryetarja e Komunës e Gucisë, Anela Çekiq, u shpreh se iu ka gëzuar përfitimit të këtij projekti dhe kjo është iniciativa e parë pas binjakëzimit të komunave, e cila ndikon në zhvillimin dhe diversifikimin e ofertave të përbashkëta turistike në mes të Gucisë dhe Pejës.

Asfaltohen disa rrugë në Podujevë

PODUJEVË, 9 NËNTOR (ER) - Në kuadër të investimeve dhe realizimit të projekteve infrastrukturore janë duke u zhvilluar punimet për asfaltimin e disa rrugëve dhe rrugicave të qytetit të Podujevës dhe në fshatin Llapashticë. Nën kryetari i Komunës së Podujevës, Nexhmi Rudari, ka inspektuar punimet në fshatin Llapashticë, ku janë asfaltuar rrugë dhe rrugica të këtij fshati.

Këto rrugë dhe rrugica lidhin disa lagje me rrugën që shpie në shkollën e fshatit.

Nën kryetari Rudari ka vizituar edhe lagjen të Tjegullorja e qytetit, ku janë asfaltuar disa rrugica në gjatësi rreth 400 metra. Me këtë rast, Rudari ka thënë se Komuna e Podujevës do t'i vazhdojë projektet e investimeve në përmirësimin e infrastrukturës edhe në lokalitete të tjera.



Nënkryetari i Gjilanit: Vendimi i qeverisë për masa shtesë, i dëmshëm për bizneset

GJILAN, 9 NËNTOR (ER) - Nënkryetari i Komunës së Gjilanit, Arbër Ismajli, ka thënë se vendimi i qeverisë për masa shtesë kundër pandemisë ishte i pamenduar mirë dhe i dëmshëm për bizneset. "Vendimet që merren prej zyrrave të qeverisë, pa e parë dhe analizuar gjendjen në terren, gjithmonë janë të dëmshme për bizneset", ka thënë Ismajli në seancën e Kuvendit Komunal. Sipas tij, Komuna e Gjilanit ka ndërmarrë masa lehtësuese që janë në kompetencë të saj, siç ishte lirimi nga pagesa e qirasë, ndërkohë po shikohet

mundësia që kjo masë të vazhdohet edhe për disa muaj. Përndryshe, Kuvendi Komunal i Gjilanit, në seancën e së hënës, nën kryesimin e Shpresë Kurteshit-Eminit, ka shqyrtuar raportin financiar janar-shtator 2020, i cili nga pozita është vlerësuar jashtëzakonisht i mirë, kurse nga opozita është cilësuar raport i mangët dhe jo sqarues sa duhet.

Drejtoresha e buxhetit, Meral Sadriu Vokshi, ka thënë se të hyrat janë realizuar në mënyrën më të mirë të mundshme, duke marrë parasysh gjendjen e pandemisë që ka mbretëruar në këtë

periudhë.

Njëherësh Kuvendi Komunal ka miratuar vendimin për formimin e grupit punës për hartimin e planit të punës të kuvendit për vitin 2021, vendimin për modifikimin etributeve të titullarit të pronave komunale dhe regjistrimin e tyre me emërtimin ligjor, iniciativën për themelimin e Muzeut Etnografik në Gjilan, vendimin për emërimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve në KRM "Ecohigjiena" si dhe vendimin për binjakëzimin e Komunës së Gjilanit me Komunën e Kumanovës.



Trumpi dhe Bideni mirëpresin zhvillimet drejt zbulimit të vaksinës


WASHINGTON, 9 NËNTOR - Presidenti i zgjedhur amerikan Joe Biden ka përhëndetur të hënën lajmin se një vaksinë kundër Covid-19, e zhvilluar nga "Pfizer" dhe "BioNTech", ishte 90 për qind efektive. Megjithatë, Bideni paralajmëroi se përpara është ende një betejë e gjatë. "Unë i përgëzoj gratë dhe burrat e shkëlqyeshëm që ndihmuan për krijimin e këtij përparimi duke na dhënë një arsye të tillë për shpresë. Në të njëjtën kohë, është gjithashtu e rëndësishme të kuptohet se fundi i betejës kundër Covid-19 është akoma me muaj larg", ka thënë ai, duke theksuar rëndësinë e vazhdueshme të mbajtjes së

maskave. Pas këtij lajmi të tij, tregjet e aksioneve evropiane dhe çmimet e naftës u rritën pas njoftimit për përparimin e bërë në drejtim të zbulimit të vaksinës. Zhvilluesit e vaksinës, kompania amerikane "Pfizer" dhe ajo gjermane "BioNTech", kanë njoftuar se kjo është një ditë e madhe për shkencën dhe njerëzimin. Vaksina e tyre është testuar në 43 500 njerëz në gjashtë vende dhe thuhet se nuk ka shqetësime për sigurinë. Kompanitë planifikojnë të aplikojnë për miratimin emergjent të vaksinës në fund të muajit. Edhe presidenti i ShBA-së,



Donald Trump, gjithashtu e përhëndeti lajmin, duke e quajtur atë "të mrekullueshëm". Të hënën Bideni emëroi shkencëtarët që do ta udhëheqin luftën kundër pandemisë në administratën e tij. Grupi i punës do të drejtohet nga tre bashkëkryesues: epidemiologu dhe ish-komisionari i Administratës Federale të Barnave (FDA), David Kessler, ish-generali kirurg Vivek Murthy dhe profesoresha e shëndetit publik në Yale, Marcella Nunez-Smith. Bordi do të ketë 10 anëtarë, duke filluar nga imunologët dhe epidemiologët, ekspertët dhe zyrtarët kryesorë të shëndetit publik.

Bosnja dhe Kroacia shënojnë shifra të larta të të vdekurve nga Covid-19



SARAJEVË, 9 NËNTOR - Autoritetet e Bosnje dhe Hercegovinës raportuan të hënën për 73 viktima të reja nga virusi Covid-19 dhe 997 të infektuar. Në territorin e Federatës së Bosnje dhe Hercegovinës u regjistruan 608 të infektuar me Covid-19 e ri dhe 52 të vdekur. Në Republikën Serbe të Bosnjës u shënuan 383 persona të infektuar dhe 19

vdekje, ndërsa në Qarkun e Bërçkos edhe gjashtë persona u diagnostifikuan me Covid-19, ndërsa dy pacientë humbën jetën nga sëmundja. Në Kroaci, në 24 orët e fundit, janë regjistruar 1 529 raste të reja me Covid-19, njoftoi Shtabi Shtetëror i Mbrojtjes Civile. Numri i rasteve aktive është 14 942, që është 726 më pak se një

ditë më parë. Gjatë 24 orëve të fundit janë regjistruar edhe 38 vdekje, kështu që numri i përgjithshëm i viktimave ka arritur në 832. Që nga fillimi i epidemisë në Kroaci më 25 shkurt, janë infektuar gjithsej 68 776 njerëz, ndërsa 53 002 janë shëruar, nga të cilat 2 227 në 24 orët e fundit. Mbi 28 mijë njerëz janë në vetizolim.

Macroni organizon samit të BE-së kundër terrorizmit

PARIS, 9 NËNTOR - Presidenti francez Emmanuel Macron të martën do të organizojë një samit përmes videolidhjes për të koordinuar një përgjigje evropiane ndaj sulmeve të fundit në Evropë, për të cilat u fajësuan radikalët islamikë. Njoftimi u bë nga zyra e presidentit Macron. Ai së pari do të takohet në Paris me kancelarin austriak Sebastian Kurz dhe të dy më pas do të diskutojnë me kancelaren gjermane Angela Merkel, shefin e Këshillit

Evropian, Charles Michel dhe presidenten e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, përmes një video-lidhjeje. Më 16 tetor, në Francë, një mësues i historisë u vra në mënyrë mizore, pasi ai e kishte ilustruar një ligjëratë për shprehjen e lirë, me karikaturën e profetit Muhamed. Një 18-vjeçar me origjinë nga Çeçenia, i lindur në Moskë, është përgjegjës për vrasjen. Sulmuesi ia kishte prerë kokën mësuesit. Pas sulmit, ai është qëlluar për

vdekje nga policia. Më 29 tetor një burrë tjetër vrau tre persona në një kishë të Nicës, në atë që presidenti francez Emmanuel Macron e përshkroi si "një sulm terrorist islamik". Ndërsa më 2 nëntor në Vjenë të Austrisë një sulmues vrau katër persona dhe plagosi 22 të tjerë. Policia austriake vrau sulmuesin e dyshuar, që e identifikua si Kujtim Fejzullai, 20 vjeç, me shtetësi të Austrisë dhe Maqedonisë së Veriut. Grupi militant, Shteti Islamik, mori



përgjegjësinë për sulmin, pa dhënë prova. Kancelari austriak

Sebastian Kurz e quajti atë një "sulm të neveritshëm terrorist".

Mbi 1 000 të arrestuar në protestat në Bjellorusi



MINSK, 9 NËNTOR - Mbi 1 000 protestues anti-qeveritarë u arrestuan të dielën në Bjellorusi, në fundjavën e 13-të të protestave që bëjnë thirrje për dorëheqjen e udhëheqësit Alyaksandr Lukashenka dhe zgjedhje të reja presidenciale. Grupi i të drejtave të njeriut Vyasna tha se, në total, 1 024 veta u arrestuan nga forcat e sigurisë, ndërsa të tjerë u rrahën brutalisht.

Shumica e arrestimeve u bënë në kryeqytetin Minsk. Grupi Vyasna tha se disa nga të arrestuarit u liruan më vonë. Lukashenka mban pushtetin në Bjellorusi qysh në vitin 1994. Ai është rizgjedhur president në muajin gusht por, sipas opozitës dhe protestuesve, zgjedhjet janë manipuluar. Vendet përëndimore refuzojnë ta njohin Lukashenkën si udhëheqës

legjitim të Bjellorusisë dhe i kërkojnë atij ta transferojë pushtetin në mënyrë paqësore. Lukashenka i mohon akuzat për manipulim të votave. Mijëra njerëz janë arrestuar qëkur autoritetet e kanë shpallur atë fitues të zgjedhjeve. Shumica e udhëheqësve të opozitës janë arrestuar ose detyruar të largohen nga Bjellorusia.



Shpella ku u hodh trupi i Azem Bejtës dhe nga e cila u nxorën eshtrat e tij pas 47-vjetësh

Përskaj varrit më të thellë në botë, shpellës së Azem Galicës

Në magjistralen Prishtinë - Pejë, po qe se nisesh nga Prishtina, në kilometrin e 50 në drejtim të Pejës, në anën e majtë të rrugës para syve të shfaqen pllakate të mëdha të metalit, të veshura me mbishkrime të dëmtuara nga rrezet e diellit, nga shiu dhe nga bora. Zënë vend në secilën prej tyre ngjyra e kuqe me të zezën. Njëra pllakate ka të shkruar "Olympi i Kosovës", një tjetër "Azem Galica (Shpella)", kurse një tjetër përskaj saj "Azem Galica Shpella Granit i shekujve". Asnjë tabelë për orientim për të "varri" më i thellë në botë nuk gjen aty. Prandaj, po nuk qëlloni atypari ndonjë banor i Gllarevës ose i Përçevës duke nxjerrë gurë, nuk di kah të shkojë njeriu për të shpellëvarri i Azem Galicës. Kështu që, po nuk qe askush aty, duhet të presësh aty derisa të vijë ndonjë banor që di për vendndodhjen e shpellës në të cilin më 1924 qe hedhur trupi i veprimtarit Azem Galica. Për ta vizituar këtë shpellë në pritëm aty rreth njëzet minuta derisa erdhi një gurmjerrës dhe gurgdhendës, i cili e kishte mbushur rimorkion e traktorit përplot gurë dhe na tha: "Shkoni drejt, kah kjo rrugë e pashtruar, rreth dy kilometra. Sapo ta shihni një lis të madh, ndaluni aty, se aty është shpella e Azemit". U nisëm, si e quajti ai, drejt "shpellës së Azemit", me shpresë se do ta gjejmë lisin, pastaj shpellën. Bëmë rreth dy kilometra rrugë pa parë askund shenjë orientuese për të shpella e tij. Ec e ec, më në fund na shohin shtë një lis jo aq të madh dhe jo aq shumë të dallueshëm nga të tjerët. Megjithatë, dallon pak prej atyre që ka përreth. Rruga për të lisi, nën rrënjët e të cilit është

shpella, s'është e shënjuar me asnjë gjë. Duhet të shkelësh drunj me këmbë e të shtysh rrema me duar për të shkuar deri te shpella e tij, e cila, kur të shfaqet, të shfaqet e befasishme, si kur të takohesh me ndonjë ari ose ujë në pyll. Pra, është shpellë e rrezikshme sepse është e pavërejtur, e parrethuar me asgjë, përpos me rrënjë dhe dushk. Po bëtë me të voglin gabim, mund të rrëshqisni dhe të fundoseni në brendinë e saj të thellë 73 metra. Prandaj, kini kujdes ku shkelnit dhe nga ç'rrem dhe ç'rrënjë kapeni aty.

Sa je pranë saj të shtohet interesimi për historinë e saj, për ndodhinë e hedhjes së trupit të Azem Bejtës në të. Por, për historinë e kësaj shpelle dinë pak banorët e fshatit. Dinë, po kaq pak, se kush i ka hedhur eshtrat e Azem Galicës në të dhe kush i ka nxjerrë. Secili prej tyre flet me "më duket se..." Prandaj, ngjarjet rreth saj dhe për të duhet t'i kërkojë në libra historikë dhe në gazeta, të cilët dhe të cilat, po ashtu, kanë shumë pak të dhëna për shpellën e Azemit. Megjithatë, duke

shfletuar libra dhe gazeta, duke lexuar studime dhe intervista të dëshmitarëve, gjen të dhënën se ky vend i shpellës quhet "Çuku që kërcet", se gjendet në malet e fshatit Përçevë të Klinës. Sipas hulumtimeve vendore dhe botërore, për shkak se në të ishte hedhur një kufomë, ai u bë varri më i thellë në botë, i cili për 47 vjet mbajti brenda vetes, nën betimin e bashkëlufitëtarëve të Azem Bejtës dhe të banorëve të Përçevës, eshtrat e tij.

Një ish-kryetar i Komunës së Klinës, Osman Krasniqi, kishte dijeni për ruajtjen e fshetësisë së varrimit të trupit të Azemit dhe kishte qëllim të rivarrimit të eshtrave të tij në Galicë. Për këtë arsye, pra për nxjerrjen dhe varrimin e eshtrave të Azemit nga shpella, Osman Krasniqi kishte biseduar disa herë edhe me dajë Kadri Imerin, bashkëlufitëtar i Azem Bejtës. Dhe, sa Osman Krasniqi ishte kryetar i Komunës së Klinës, njerëzit e aksionit për nxjerrjen e eshtrave të Azemit kishin besim tek Osmani për shkak të rrethanave të krijuara nga puna e mirë e tij në Klinë dhe

rrethinë. Prandaj, me insistimin e tij, nga Drejtoria e Mbrojtjes Popullore dhe kryeshefi Hysen Krasniqi u morën masat për hyrje në shpellë.

Më 22 deri më 28 maj 1971 ishte ngritur kampi për t'u lëshuar me konop me çikrik në këtë shpellë. Cenë Gashi nga fshati Përçevë, tash i ndjerë, në fejttonin e publikuar në vitin 2003 kujton: "Aty më kanë ardhur në ndihmë disa të rinj, bashkëfshatarë të mi. Filluan të më lëshojnë në shpellë. Me ndihmën e tyre mbërrita te vendi i eshtrave të Azemit. Aty pashë mbeturina dhe zall të imët. U kërkova të më tërhiqnin me litar. Kur dola u thashë burrave se në shpellë duhet të hyjnë dy veta. Po ashtu, u tregova se kam arritur te vendi ku janë eshtrat e Azemit, por duhet të hiqet një pjesë e mbeturinave që të nxirren eshtrat e tij. U thashë se nëse nuk do të më ndihmonte askush prej tyre, do ta merrja vajzën time që sapo i kishte mbushur katër vjet, e cila do të ma mbante llambën e karbitit, kurse gropimin deri te eshtrat e Azemit do ta bëja vetë. Por, vendosëm që unë dhe Avdyli

Krasniqi të lëshoheshim në shpellë. Avdyli ma mbante llambën e karbitit. Pasi i hoqa zallin dhe mbeturinat, i gjeta eshtrat e Azem Galicës dhe i mbështolla në çarçaf të bardhë. Kur e gjeta kafkën e Azemit e mbështolla me plisin tim të bardhë me qëllim që të mos shkapërderdhej dhe, bashkë me Avdyli Krasniqin, i nxorëm mbi sipërfaqe të shpellës, me ndihmën e djemve jashtë, të cilët me çikrik e ngrehnin litarin me të cilin ishim lidhur unë dhe Avdyli. Në sipërfaqe të shpellës ishin tubuar rreth 30 bashkëfshatarë edhe të fshatrave përreth. Me çikrik na kanë nxjerrë nga shpella Zymer Hyseni, Islam Shabani, Sefer Zeqiri etj. Pasi dolëm prej saj eshtrat e Azemit i vendosëm në një sënduk të ushtrisë, pastaj në një dollap të odës sime i kam ruajtur edhe me pushkë në dorë, sepse kështu e kishte lënë amanet Azemi".

Këta eshtra Cenë Gashi i ka ruajtur në kullën e vet çdo ditë dhe natë. Për këtë akt ishte informuar edhe kryetari i atëhershëm i Komunës së Klinës, Osman Krasniqi, i cili qe angazhuar të kontaktonte me drejtuesit e atëhershëm politikë të Kosovës dhe me insistimin e tij, duke marrë përgjegjësinë për rivarrimin e eshtrave, ishte arritur pëlqimi që eshtrat e Azemit të varroseshin pa u bërë zhurmë politike.

Osman Krasniqi dha kontribut të madh për rivarrimin e eshtrave të Azem Bejtës në maj të vitit 1971. Ai e dinte mirë kush ishte heroi ynë kombëtar, andaj tri ditë dhe net nuk pushoi së punuari që eshtrat e Azem Galicës të mos hidheshin përsëri në shpellë, siç



kishte urdhëruar Veli Deva. Osmani mori tërë përgjegjësinë dhe ia doli që rivarrimi i eshtrave të heroit kombëtar të bëhej në fshatin e tij të lindjes, në Galicë. Pas tri ditësh e netësh punë me drejtuesit e komunave Skenderaj, Vushtrri dhe me vajzën e Azemit, Azeminën, u pajtuan për rivarrimin e eshtrave të Azemit më 28 maj të vitit 1971, me nderime, siç e meritonte. Edhe pse ky veprim ishte në kundërshtim me politikën e atëhershme, Osmani ishte i vendosur të organizohej një rivarrim solemn i eshtrave të Azem Galicës. Me mençurinë dhe largpamësinë e tij e me qëllim që të ngadhënjente mbi kundërshtarët politikë dhe mbi nacionalët serbë, ai propozoi që rivarrimi i tij të bëhej nën përkujdesjen e Lidhjes Socialiste të Komunës së Klinës, kryetar i së cilës ishte shovinisti serb Bozho Gariqi. Në krye të këshillit për rivarrim, pavarësisht prej dëshirës së tij, u zgjodh Bozho Gariqi ngaqë, sipas pozitës që kishte, duhej të zgjidhej ai. Madje ai u angazhua të fliste në fshatin Galicë për historinë e heroit Azem Galica. Ky organizim i rivarrimit i befasoit shumë edhe pjesëmarrësit e rivarrimit në fshatin Galicë, që ishin të shumtë nga Komuna e Klinës, e Skenderajt, e Vushtrrisë e më gjërë.

Pasi u nxorën eshtrat dhe u vendosën në vend të sigurt, në arkën e odës së Cenë Gashit, u nisën lajmëtarët për në Galicë. Vendlindja e këtij trimi këtë sihariq e prit me gëzim. I madh dhe i vogël u çuan në këmbë për ta pritur të birin e tyre, i cili, pas 47-vjetësh po kthehej në vendlindje për t'u prehur, aty ku kishte lindur. Galicasit e thërrasin kuvendin dhe vendosin që rivarrimi i eshtrave të bëhet në vendin ku ishte zhvilluar beteja e fundit, aty ku trimi e kishte kullën. Po atë natë në Komunën e Vushtrrisë, Klinës dhe Skenderajt ishte formuar komisioni për

bartjen e eshtrave. Në Prishtinë ishte dhënë paralajmërimi se sa më shpejt duhet bërë rivarrimi sepse ka lajme që eshtrat e tij të dërgohen në Beograd për ekspertizë mjekësore. Të nesërmen, në orën 7.00, me automobilin e Komunës së Vushtrrisë janë nisur për në Përçevë, pos kryetar Osman Krasniqit, aktorëve të nxjerrjes së eshtrave, komisionit komunal për rivarrim dhe shumë qytetarëve nga Klina. Këta qytetarë i ka shoqëruar edhe makina e policisë (vetë komandanti me dy policë) nga Klina, për në Përçevë dhe në kortezhin e rivarrimit në Galicë. Në malin e Përçevës, te shpella "Çuku që kërcet", ishte rregulluar vendi si për dasmë. Ishte pastruar terreni përreth shpellës, ishin prerë shkurret dhe ishin shtruar qilima dhe sixhade. Rreth 50 burra kishin dalë në pritje. Pas një ceremonie të shkurtër të gjithë janë nisur për në shtëpinë e Cenë Gashit në Përçevë. Këtë borxh kishin klinasit sepse këndej pari luftoi Azemi, vdiq dhe u varros. Kjo anë e ruajti me fshehtësi të madhe varrin shpellë të tij.

Te dera e kullës, ku ruheshin eshtrat, bënë rojë dy burra të armatosur. Eshtrat i kishin futur në një arkë prej druri, kurse arkën e kishin futur në dollap, mbyllur me dyer. Edhe në shtëpinë e Cenës është bërë një ceremoni e shkurtër pastaj, pasi janë marrë prej aty, i kanë nisur për Galicë. Rrugës për në Galicë kalvarit vazhdimisht i bashkëngjiteshin njerëz. Erdhën njerëz nga Klina, Prishtina, Gllogoci, Vushtrria, Mitrovica e nga Skenderaj. Në Galicë, edhe pse nuk ishte lajmëruar si duhet, po grumbulloheshin njerëz. Varri ishte hapur. Njerëzit po prisnin në heshtje. Ishte një varrim i pazakonshëm. Po rivarrosej biri më i madh i tyre, heroi i Drenicës, i Kosovës dhe i mbarë Shqiptarisë, kryekomandanti i çetave kryengritëse të viteve 1915-1924. Po rivarrosej Azem Bejtë Galica. Herën e parë ishte



varrosur nga 4-5 veta në varrin shpellë të thellë 73 metra. Për gjetjen e shpellës e për varrimin e Azemit ndihmuan Halim e Hamit Ngucati nga Përçeva të cilët siguruan edhe jorganë për mbështjelljen e kufomës. Halimi ishte në mesin e katër shokëve që, bashkë me Shotën, kishin lëshuar kufomën e Azemit në shpellë. Pas hedhjes së kufomës, në shpellë qe hedhur një dru për çështje sigurie. Pas vdekjes së Azemit, me Shotën në Shqipëri shkoi edhe Halim Ngucati, të cilin e vranë partizanët në fund të vitit 1944. Ky kishte ikur 20 vjet nga Jugosllavia e vjetër, por e vrau Jugosllavia "e re"! Hamiti, edhe pse mori rafalë plumbash, po vdiste duke qeshur. Por, për t'ia ndalë buzëqeshjen, shtënë për së dyti dhe për së afërmi në të, thonë dëshmitarët që panë këtë krim. Shumica e njerëzve, qindra mijëra veta, kishin dalë te xeherorja e magnezitit, pranë zyrës së vendit dhe po e prisnin delegacionin me eshtrat e Azemit. Dikur pasdite delegacioni arriti. Brenda në zyrë u bënë përgatitjet e nevojshme. Aty ishin edhe mjekët Fevzi Dërvari dhe mjeku nga Prespa, Sako Sakoja, drejtor i atëhershëm i Shtëpisë së Shëndetit në Vushtrri. Pasi u nxorën eshtrat nga arka, u

radhitën nga mjekët e lartpërmendur në arkivolin e ndërtuar nga punëtorët e NP "Kosova" dhe i njëjti u mbulua me flamurin kombëtar. Prej aty arkivoli u bart në duar të njerëzve, sipas zakonit, deri në Galicë. Pas tij shkonte kortezhi i gjatë i njerëzve, i mësuesve dhe i nxënësve. Te varri prisnin të tjerët. Aty kishin ardhur edhe bashkëluftëtarët të Azem Galicës. Ata derdhën edhe disa pika loti. Pasi u kryen ceremonitë dhe ritet e zakonshme, u bë rivarrimi i eshtrave. Pra, më 28 maj 1971, në orën 18.30, u rivarrosën eshtrat e Azem Bejtë Galicës, aty ku e kishte zhvilluar betejën e fundit, epopenë e lavdishme, më 15 korrik 1924.

PROPOZIM PËR MINISTRINË E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT DHE DREJTORINË E KULTURËS TË KOMUNËS SË KLINËS:

Shpella, e quajtur "Azem Galica", duhet të shndërrohet në atraksion turistik për vizitorë vendorë dhe të huaj e të mos mbetet vetëm objekt për

hulumtim nga historianë, antropologë, etnologë, filologë etj. Prandaj, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Departamenti i Trashëgimisë Kulturore, duhet të bëjë investime atje, duke bërë shtrimin e rrugës me zhavorr dhe me rërë deri te shpella, e gjatë rreth dy kilometra, ta shënjojë rrugën deri te shpella, ta rrethojë shpellën me gardh metalik dhe të vendosë përkaj saj shenja të kujdesit për qytetarë pasi që, meqë është e fshehtë, përbën rrezik për vizitorët.

PËR TË DHËNA TË TJERA:

Asllan Krasniqi, Klina me rrethinë në valët e historisë, <http://www.zemrashqiptare.net/news/5129/adem-berisha-klina-merrrethine-ne-valet-e-historise-i.html?skeword=a> (shikuar më datë 9 dhjetor 2020)

Asllan Krasniqi, Qëndresa shqiptare dhe terrori serb, Azem Bejtë në Përçevë, "Bashkimi", Prishtinë, 1991
Asllan Krasniqi, Kujtime, dorëshkrim

Asllan Krasniqi, Reshit Gashi, Met H. Durmishi: (monografi në 79-vjetorin e lindjes), "Koliqi", Prishtinë, 2019

Bedri Tahiri, Azem Bejtë Galica, pjesa e tretë, në 85-vjetorin e betejës së fundit të Azem Bejtë Galicës, publikuar më 6 korrik 2009; <http://www.albaniapress.com/lajme/9345/AZEM-BEJTE-GALICA-PJESA-III-.html> (shikuar më datë 09.10.2020)

Cen Gashi, pas 32 vjetëve, rrefen se si i ka zbuluar eshtrat e trimit legjendar Azem Bejtë Galicës: Që në moshën 11-vjeçare më ishte ngulitur në kokë se unë do t'i nxjerrja nga shpella eshtrat e Azemit, "Bota sot", 2 mars 2003, fejttoni 3

Deklaratë e Osman Krasniqit, Klinë, dhjetor 2000

Gani Morina, Kur dhe si e kam njohur Osman Krasniqin, dorëshkrim, Klinë, 2012

Kujtime nga Islam dhe Osman Krasniqi dhënë Asllan Krasniqit dhe Reshit Gashit, dhjetor 2000


Kujtime të Beqir Qupevës dhënë Asllan Krasniqit dhe Reshit Gashit më 05.07.2017

Cen Gashi, Vendosa që eshtrat e Azemit t'i mbroja edhe me pushkë që të mos binin në duar të shkive, "Bota sot", 3 mars 2003, fejttoni 4

(Ky artikull është përgatitur në kuadër të projektit kulturor "Observimi i traditës", realizuar nga Qendra për Kulturë dhe Edukim "Sheshi", Prishtinë).



Osman Krasniqi me ekipin e vet në varrimin e eshtrave të Azem Galicës më 28 maj 1971



Letrat që Luigi Pirandello ia shkroi Zef Skiroit

Nga: Matteo MANDALA

Sasia e madhe e dokumenteve, më së shumti të pabotuara, që kanë dalë në dritë këto dhjetëvjeçarët e fundit, na lejon të njohim më mirë veprimtarinë letrare që zhvilloi Zef Skiroi gjatë periudhës rinore, sidomos gjatë viteve '80 të shek. XIX, që ishin ndër më të rëndësishmet e krijimtarisë së tij. Mes këtyre dokumenteve rëndësi të veçantë paraqesin letrat që ndër vitet 1886-1890 i dërgoi Luigi Pirandello, sepse këto japin një ndihmesë, shpeshherë vendimtare, qoftë në rindërtimin e kuadrit historik e kulturor palermitan në të cilin u ngjizën veprat rinore të poetit arbëresh, qoftë në qëmtimin e elementeve biografike private, marrëdhënieve shoqërore dhe ndjenjave që e nxitën dhe e frymëzuan. Po aq të rëndësishme janë këto letra për Pirandello-n: nga njëra anë ato ndihmojnë në rindërtimin e njëjës prej përvojave më interesante që përjetoi shkrimtari dhe dramaturgu i shquar italian gjatë periudhës së miqësisë së ngushtë me Zef Skiroin. Nga ana tjetër, këto letra japin dorë për një shqyrtim kritik më të thellë e më të kujdesshëm të krijimtarisë së gjerë rinore të Pirandello-s, një pjesë e mirë e së cilës i përket pikërisht periudhës kur banonte në Palermo. Pa kuptuar drejt vlerën që pati ajo

periudhë rinore për jetën private dhe publike të Pirandello-s, që i la mbresa aq të thella sa e bëri të piquej para kohe, ndoshta Leonardo Sciascia nuk do të kishte shkruar se *“pa aventurën e s'qafurit nuk do të kishte qenë as aventura e të shkruarit e të rrëfyerit”*, ndërsa Andrea Camilleri nuk do t'i kishte vënë librit të tij, kushtuar Pirandello-s, titullin *“Biografia e një biri të ndryshuar”*. Në këto shënime të shkurtra do të lëmë mënjanë ato pjesë të letërkëmbimit që hedhin dritë mbi zhvillimet artistike të dy miqve në periudhën kyçe të formimit të tyre rinor, pasi do të përqendrojmë vëmendjen vetëm në disa momente njerëzore dhe intelektuale të marrëdhënies së tyre, duke e lënë për një rast tjetër thellimin e aspekteve mirëfilli letrare.

Pirandello njihet me Skiroin aty nga viti 1882, kur u transferua bashkë me familjen në Palermo, ku prej disa vitesh ishte vendosur Zefi. Prej asaj kohe dy të rinjtë lidhën një miqësi të ngushtë dhe të sinqertë, që ushqej, përveçse nga një vlerësim i ndërsjellë, edhe nga interesa e aspirata të përbashkëta artistike dhe letrare. Deri pas vitit 1890 kur marrëdhëniet mes tyre u ftohën, Pirandello dhe Skiroi mbajtën një letërkëmbim të rregullt, prej të cilit na ka mbërritur vetëm një pjesë e letrave që ata i shkruan njëri-tjetrit.

Korpusi i letërkëmbimit, përveç letrave që kemi në dorë, duhej të

përbante medoemos edhe të tjera që kanë humbur. Nuk dimë asgjë mbi letrat që Skiroi i shkroi Pirandello-s. Deri më sot njihen vetëm letrat që Pirandello u shkroi familjarëve dhe miqve. Megjithëse ka shumë të ngjarë që Pirandello të mos i ketë ruajtur letrat e Skiroit, nuk përjashtohet që ato të gjenden diku në ndonjë arkiv privat. Botimi i plotë i letrave i përket vitit 2002 (shih *Peppino mio: lettere di Luigi Pirandello a Giuseppe Schirò (1886-1890)*, a cura di Antonino Perniciaro, Filomena Capobianco, Cristina Iacono, con un saggio introduttivo di Matteo Mandala, Biblioteca museo Pirandello di Agrigento, 2002), pas një botimi të pjesshëm dhe të cungët të vitit 1994 (*Luigi Pirandello, Amicizia mia. Lettere inedite al poeta Giuseppe Schirò (1886-1887)*, a cura di A. Armati, A. Barbina, Istituto di studi pirandelliani. Quaderni 9, Bulzoni, Roma, 1994).

Pirandello qëndroi në Palermo gjatë viteve 1882-1887. Skiroin me gjasa do ta ketë takuar korridoreve të liceut klasik “Vittorio Emanuele II” të Palermos: Skiroi, dy vjet më i madh, e mbaroi liceun në vitin 1884, ndërkohë që Pirandello ishte ende në vitin e dytë. Këtyre viteve u përkasin sprovat e para letrare. Shtatëmbëdhjetëvjeçari Luigi në vitet 1884-1885 botoi regimet e para. Nga ana e tij, Zefi, mes viteve 1882 dhe 1885 botoi disa lirika italisht në *La Nuova*


Età e më vonë, në vitin 1885, falë interesimit të kushërirës Cristina Gentile Mandalà, botoi disa poezi të *Fiamuri Arbërit*, që ishte themeluar e drejtuar nga De Rada. Këto sprova të para letrare i bashkajnë dy të rinjtë dhe u hapin rrugën veprave të mëpasme.

Dy të rinjtë nuk takoheshin vetëm në shkollë. Familja e Pirandello-s fillimisht u vendos me banim në rrugën Porta di Castro, pranë Pallatit Mbretëror të Normanëve, e pas një viti u transferua në lagjen Borgo, pranë Foro Italico, në një apartament që gjendej përballë kishës së Shën Luçisë; ndërsa familja e Skiroit u vendos në rrugën Porrazzi, që gjendej në krah të Corso Vittorio Emanuele. Pra të dy banonin në qendër të qytetit, fare pranë liceut, por edhe pranë bibliotekës publike Vittorio Emanuele, që të dy e frekuentonin rregullisht. Gjatë kësaj periudhe Pirandello shkante shpesh edhe në shtëpinë e Skiroit, ku të dy bashkë ushtroheshin në artin e vargëzimit. Me siguri Pirandello njihnte edhe vëllanë e Skiroit, sepse e përmend në letrën e tetorit 1887.

Kjo nuk ishte një shoqëri e rastit, por një miqësi e qëndrueshme që u forcua falë takimeve të shpeshta, interesave dhe shqetësimeve të përbashkëta e madje edhe falë dashurive të para. Skena ideale e kësaj miqësie ishte Palermo, “qyteti i nismave

taraskoniane”, sikundër do ta quajë Pirandello në letrën që i dërgon më 27 gusht 1887 mikut Carmelo Faraci, i lumtur që pikërisht aty ka kaluar periudhën *“më të mirë të jetës së tij të varfër”, “stinën më të bukur”*. Imazhi i Palermos fin de siècle do të mbetet i pashlyeshëm në zemrën dhe në mendjen e të riut Luigi. Shëtitjet më këmbë a me karrocë përgjatë Foro Italico ose nëpër rrugët e gjera të qendrës, rrethuar me ndërtesa të mrekullueshme të stilit liberti, mes rrugës Maqueda dhe corso Vittorio Emanuele, lokalet që frekuentoheshin nga studentët, akullotimet e zjarrta mbi politikën dhe letërsinë, bëmat dashurore, dyshimet dhe pasiguria për të ardhmen; këto kujtime do të ringjallen shpesh në kohën e pjekurisë dhe as vitet, as buja e suksesit nuk do të mund t'i shlyejnë dot.

Periudha e parë e banimit në Palermo për Pirandello-n zgjati deri në verën e vitit 1885, ndërsa qëndrimi i dytë në Palermo u zgjat për gjithë dimrin e vitit 1886 deri më 14 korrik kur u kthye në



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

'Dardanët' grumbullohen në Durrës, mungojnë Rashica dhe Paqarada

Milot Rashica dhe Leart Paqarada do të jenë dy mungesat e tjera të Përfaqësueses së Kosovës për ndeshjet e muajit nëntor. Ndërsa Valon Berisha dhe Idriz Voca pritet t'u bashkohen "dardanëve" në dy ndeshjet e Ligës së Kombeve



PRISHTINË, 9 NËNTOR - Përfaqësuesja Kosovës në futboll është grumbulluar të hënën në hotel "Premium" në Durrës në kuadër të përgatitjeve për tri ndeshjet e këtij muaji kundër Shqipërisë (më 11 nëntor), Sllovenisë (më 15 nëntor) dhe Moldavisë (më 18 nëntor). Sipas njoftimit të Federatës së Futbollit të Kosovës për këto ndeshje futbollistët Milot Rashica e Leart Paqarada nuk janë lejuar nga klubet e tyre të udhëtojnë për shkak të vendimeve të regjioneve përkatëse që pas kthimit ata duhet të qëndrojnë në karantinë dhe klubet kanë ushtruar të drejtën e dhënë nga FIFA që të mos i lejojnë lojtarët që të

bashkohen me ekipin përfaqësues. Në tri ndeshjet e këtij muaji do të mungojë edhe Florent Muslija, i cili nuk është në gjendje t'i bashkohet ekipit pas lëndimit në ndeshjen e fundit, si dhe Benjamin Kololli, i cili është i suspenduar për dy ndeshjet e Ligës së Kombeve ndaj Sllovenisë e Moldavisë për shkak të kartonit të kuq pas ndeshjes kundër Greqisë. "Duke pasur parasysh se në ndeshjen e fundit me Zurichun pësoi një lëndim të lehtë në bashkëpunim me lojtarin është vendosur që të mos rrezikohet, meqë edhe ashtu do të mund të luante vetëm në ndeshjen miqësore", thuhet në njoftimin e FFK-së.

Në miqësoren kundër Shqipërisë do të mungojnë edhe Valon Berisha e Idriz Voca. Në fakt, Berisha, pas problemeve konstante në shpinë në ndeshjet e fundit me klubin, është vendosur që të kryejë rikuperim të lehtë gjatë tri ditëve dhe pastaj t'i bashkohet ekipit nga dita e enjte për dy ndeshjet e Ligës së Kombeve ndaj Sllovenisë dhe Moldavisë. Ndërkaq, Voca ka pësuar lëndim para ndeshjes së djeshme me klubin dhe pritet të shihet rikuperimi i tij dhe përfshirja eventuale në ekip për dy ndeshjet e Ligës së Kombeve. "Dardanët", po ashtu, të hënën në kompleksin "Tropical" në Durrës kanë zhvilluar stërvitjen e parë.

SHKURT

Inzaghi: Jam i lumtur me kontributin e Muriqit

Sulmuesi i Kosovës, Vedat Muriqi është kritikuar kohët e fundit për paraqitjet me fanellën e Lazios. Mirëpo, sulmuesi "dardan" është përkrahur nga trajneri Simone Inzaghi. "Vedat Muriqi do të mësohet me ekipin çdo ditë e më shumë. ADN-ja e Lazios është ndryshe dhe duhet kohë për të mësuar. Unë jam i lumtur me kontributin e tij. Do të jetë edhe më mirë", ka thënë Inzaghi.

Dy shqiptarë në formacionin e javës në Zvicër

Futbollistët e Zurichut me origjinë nga Kosova, Benjamin Kololli dhe Toni Domgjoni janë përzgjedhur në ekipin e javës të Superligës zvicerane. Zurich e mposhti 2-0 Luzernin në fundjavë, teksa Kololli realizoi gol si dhe nxjerri një penalti për skuadrën. Domgjoni luajti për mrekulli në mesfushë, duke gabuar vetëm një pasim gjatë gjithë ndeshjes dhe duke kontribuar në aksionet e rrezikshme të Zurichut.

6 futbollistë të Salzburgut infektohem me koronavirus

Skuadra Red Bull Salzburg ka njoftuar se gjashtë futbollistë të saj kanë rezultuar pozitivë në testet e Covidit-19. Pjesë e Salzburgut janë edhe dy kosovarë, Albert Valci e Mërgim Berisha. Por, kampionët e Austrisë nuk kanë bërë të ditur emrat e të infektuarve me koronavirusin. Salzburgu të dielën kishte ndeshjen derbi ndaj Rapid Vienës, ndërsa testet kanë dalë në mëngjesin e së hënës. Në njoftimin e skuadrës thuhet se të gjithë lojtarët e tjerë janë futur në karantinë.

Kastrati shënon 10 pikë ndaj Yllit të Kuq

Erjon Kastrati është një nga lojtarët më të dalluar të Kosovës. Ai po aktivizohet me sukses në skuadrën e tij, Koper Primorska. Gjithsesi, skuadra e tij ka pësuar humbje nga Ylli i Kuq në kuadër të xhiros së gjashtë të Aba Liga, që përfundoi 72:84 (14:28, 24:21, 22:16, 12:19). Kastrati u aktivizua për 27 minuta në këtë përballje, duke shënuar 10 pikë, por kishte edhe tri kërcime, një asistim dhe një top të vjedhur. Në përgjithësi këtë edicion, Erjon Kastrati, ka mesatare prej 9 pikëve për ndeshje, duke u aktivizuar për 27 minuta. 26-vjeçari nga Prishtina ndodhet në formë të mirë para ndeshjeve para-kualifikuese për Kupën e Botës 2023, ku Kosova do të përballet me Sllovakinë dhe Islandën, më 26, përkatësisht 28 nëntor. Pavarësisht ndeshjeve të mirë të Erjonit, skuadra e tij ndodhet në vendin e fundit me gjashtë humbje në gjashtë ndeshje të zhvilluara.

Futbolli rikthehet me derbi

PRISHTINË, 9 NËNTOR - Java e dymbëdhjetë në Superligën e Kosovës në futboll, e planifikuar që të zhvillohet në fundjavën që e lamë pas dhe e shtyrë për shkak të vendimit të Qeverisë së

Kosovës, do të zhvillohet në këtë mesjavë. Sot (e martë) zhvillohen tri ndeshje, kurse vëmendja do të jetë në derbin që zhvillohet në Gjilan mes Dritës dhe Prishtinës. Këto dy klube do të luftojnë për

fitore pasi janë ndër dy favoritët në garën për titull të kampiones. Në Skenderaj, Drenica e pret Feronikelin, kurse në Podujevë zhvillohet përballja në mes të Llapit dhe Trepçës '89. Nesër (e

mërkurë) takohen Arbëria dhe Besa, kurse ndeshja në mes të Ballkanit dhe Gjilanit është shtyrë për një kohë të pacaktuar. Të gjitha ndeshjet zhvillohen nga ora 13:30.



Verstappen: Respekt për Hamiltonin, por me atë makinë fitojnë të gjithë

HASSELT, 9 NËNTOR - Max Verstappen vijon ta thumbojë britanikun Lewis Hamilton në lidhje me fitoret e titujt e njëpasnjëshëm që po fiton piloti i Mercedesit. Sipas tij, përveç meritave të

pilotit, ndikon shumë fakti se ai ka një makinë që nuk e kanë rivalët e tjerë. "Kam shumë respekt për atë që Hamiltoni ka bërë në këto vite dhe nuk kam aspak xhelozitë që e shoh te

Mercedesi. Gjithsesi, të jem i sinqertë, 90 % e pilotëve aktualë të Formulës 1 mund të fitojnë një garë apo titull me atë makinë që ka ai", ka thënë Verstappen. "Nuk kam asgjë kundër tij. Është një

pilot i madh, por e vërteta është që ai ka një makinë që po dominon në Formula 1 dhe kjo e ndihmon shumë, duke i lehtësuar punën", u shpreh Verstappen që piloton makinën Red Bull.



Lowi, gati ta rikthejë në kombëtare heroin e 2014-s

Berlin, 9 nëntor - Sulmuesi i PSV-së, Mario Gotze, mund të rikthehet sërish në Kombëtaren e Gjermanisë. Ka qenë vetë tekniku Joachim Low që ka konfirmuar lajmin që ka entuziazmuar shumë tifozë. 28-vjeçari duket sikur ka rilindur në Holandë dhe falë paraqitjeve të mira që ka bërë, ai mund të fitojë sërish një vend te Gjermania. "Kam qenë në kontakt me Marion javët e fundit dhe ai më ka mbajtur të informuar mbi situatën e tij. Duket se është shumë në formë dhe i freskët, kjo është më se e dukshme. Do ta kemi gjithmonë vëmendjen te Goetze, kjo është e sigurt", ka deklaruar tekniku gjerman. "Sipas këndvështrimit tim, ai ka bërë zgjedhjen e duhur që u largua nga Dortmundi. I duhej një aventurë e re larg Bundesligës. Jam shumë i lumtur për të që e ka nisur kaq mirë sezonin me Eindhovenin. Kjo ishte e papritur", ka shtuar Low. Kujtojmë që heroi i Gjermanisë në Botërorin e 2014-s ka luajtur deri më tani gjashtë ndeshje me PSV-në, ku ka shënuar edhe tri gola.



Joshua: Synoj t'ia rrëmbej Furyt titullin e WBC-së

LONDËR, 9 NËNTOR - Boksieri britanik Anthony Joshua, kampion bote në peshën e rëndë (kategoritë IBF, WBA e WBO), ka deklaruar se prej kohësh mendon edhe për titullin e vetëm që i mungon, ai i kategorisë WBC. Ky titull mbahet nga patrioti i tij Tyson Fury. Dy boksierët britanikë synojnë të zhvillojnë dy duele vitin e ardhshëm. "Të mbaj të gjithë titujt e peshës së rëndë ka qenë gjithnjë dëshira ime më e madhe. Unë do ta marr edhe titullin WBC. Dëshiroj të dueloj me më të fortët, sfidat e rëndësishme", ka thënë Joshua. "Ka vetëm një mënyrë për t'u bërë më i mirë, të dueloj me më të mirët. Të dueloj për titullin e kategorisë WBC do të jetë nder për mua. Është një titull prestigjioz dhe synoj t'ia rrëmbej Furyt atë titull me duart e mia", ka shtuar ai. Joshua do të duelojë fillimisht më 12 dhjetor ndaj bullgarit Kubrat Pulev. "Kur të vijë dita dhe momenti i duhur do të përballem me Furyt", ka deklaruar Joshua.



Juventus vendos ta shesë Ronaldon

Juventus ka vendosur që ta shesë yllin e skuadrës, Cristiano Ronaldo, në afatin kalimtar të verës. "Sport" raporton se "Zonja e Vjetër" po planifikon ta shesë

futbollistin portugez për shkak të pandemisë së koronavirusit që ka ndikuar negativisht në financat e klubit. Ronaldo fiton rreth 540 mijë euro në javë, që

është katër herë më shumë se lojtari i dytë më i paguar në klub, pra Matthijs de Ligt. Kontrata momentale 35-vjeçarit i skadon në vitin 2022 dhe gjiganti italian

shpreson ta shesë dhe të mos e lejojë pas dy vjetëve të largohet si agent i lirë. Interesim për Ronaldon në të kaluarën ka treguar PSG-ja, skuadër e cila

thuhet se do të provojë ta transferojë edhe në afatin veror. Juventus shpreson ta shesë pesë herë fituesin e "Topit të Artë" për së paku 50 milionë euro.

SHKURT

Aksident i frikshëm nga Eto'o, kjo është gjendja e tij

Ish-kapiteni i Kamerunit, Samuel Eto'o, ka shpëtuar pa u lënduar nga një aksident me makinë të dielën. 39-vjeçari po udhëtonte nga Douala drejt Bafoussam në Kamerun kur makina e tij "4x4" me të cilën po udhëtonte u përplas kokë me kokë me një autobus. Një zëdhënës i ish-sulmuesit të Interit dhe Barcelonës ka thënë për "BBC Sport Africa" se Eto'o nuk e ka pësuar asnjë lëndim dhe kjo është konfirmuar pas vizitës së tij në spital për kontroll. Eto'o ka vendosur të mos e padisë shoferin e autobusit i cili kishte bërë përpjekje të ikte nga vendi i ngjarjes para se të arrestohej nga policia. Në vend se ta padiste, Eto'o është parë duke i folur butësisht shoferit dhe duke i bërë thirrje të vozisë me më shumë kujdes.

Kimmich rikthehet në janar

Bayern Munchen ka pranuar lajme të këqija nga kampi mjekësor për lojtarin e tyre Joshua Kimmich, i cili do të mungojë deri në muajin janar për shkak të operacionit në gju. "Ne jemi të lumtur që Joshua do të jetë i gatshëm për ne përsëri në disa javë. Ne do t'i japim përkrahjen më të mirë atij gjatë rikuperimit", ka thënë drejtori Sportiv i gjigantit gjerman, Hasan Salihamidziq.

Celta Vigo shkarkon trajnerin

Barazimi 1-1 me Echen në kampionat ishte fatal për të ardhmen e Oscar Garcias, i cili u shkarkua nga drejtimi i Celta Vigos pikërisht për rezultate negative. Aktualisht skuadra mban vendin e 17 në tabelën e renditjes me 7 pikë të grumbulluara dhe vetëm një ndeshje të fituar në 9 javë kampionat. 47-vjeçari e mori drejtimin e skuadrës nga "Estadio de Balaidos" në nëntor të 2019-s, duke e shpëtuar nga rënia nga kategoria dhe duke i siguruar qëndrimin në La Liga për këtë sezon.

Depay: Vështirë të jem në Lyon pas janarit

Barcelona ishte shumë pranë Mephis Depay në verë, por rregullat e La Ligës nuk e lejuan të mbyllej ai transferim. Gjithsesi asgjë nuk ka përfunduar sepse futbollisti holandez mund të bashkohet me katalanasit në janar. "Te Lyon deri në fund të sezonit? Ma bëni shumë këtë pyetje. Nuk do të bëj premtime të cilat nuk jam i sigurt nëse do t'i mbaj. Mendoj se Lyoni duhet të përfitojë nga prania ime këtu tani dhe unë të përfitoj nga të qenit këtu", ka thënë Depay.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Shëndetësisë/ Ministarstvo Zdravstva/ Ministry of Health

Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale/ Kosovska Agencija za Lekove i Medicinska Sredstva/ Kosovo Medicines Agency

KONKURS

Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, në bazë të Nenit 7 të Ligjit Nr. 04/L-190 për Produkte dhe Pajisje Medicinale shpall konkurs për emërimin e 7 anëtarëve të Komisionit (KVPPM) si :

1. 3 farmacistë
2. 1 doktor i mjekësisë
3. 1 doktor i stomatologjisë
4. 1 farmakolog klinik
5. 1 anëtar kimist, biolog, biokimist etj i fushës përkatëse

Paga mujore: në bazë të takimeve

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Komisioni është përgjegjës për dhënien e këshillave teknike dhe shkencore për AKPPM lidhur me lëshimin dhe mirëmbajtjen e autorizimit për marketing të produkteve medicinale si dhe performansën dhe sigurinë e pajisjeve medicinale. Këshillat e komisionit janë rekomanduese për AKPPM.

Kualifikimi i kërkuar:

- Pozita 1 - Diploma e Universitetit - Fakulteti i Mjekësisë, Drejtimi i Farmacisë (minimum 4 vjeçar pas shkollës së mesme), së paku specializimi ose magjistratura, preferohet doktoratura.
- Pozita 2 - Diploma e Universitetit - Fakulteti i Mjekësisë, së paku specializimi ose magjistratura, preferohet doktoratura.
- Pozita 3 - Diploma e Universitetit - Fakulteti i Mjekësisë, Drejtimi i Stomatologjisë së paku specializimi ose magjistratura, preferohet doktoratura.
- Pozita 4 - Diploma e Universitetit - Fakulteti i Mjekësisë, së paku specializimi nga farmakologjia klinike, preferohet magjistratura ose doktoratura.
- Pozita 5 – fakulteti i kimisë, biologjisë, mjekësisë – biokimi etj sipas fushës së konkurimit, magjistratura nga lemia perkatëse, sepaku specializimi nga biokimia klinike-per biokimistet, preferohet doktoratura

Aftësitë, përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:

- Duhet të kenë shkathhtësi në përcaktimin dhe arritjen e objektivave strategjike të institucionit, aftësi të shkëlqyeshme të komunikimit dhe negocimit, aftësi të dëshmuara për analizën e gjendjes dhe ofrimin e opsioneve, njohuri bazike në programet e kompjuterit, së paku 5 vjet përvojë profesionale, e preferueshme në nivele të larta dhe në fusha që ndërlihen me punën e Agjencisë, njohja e gjuhës angleze e obliguar.

Kohëzgjatja e emërimit:

- Mandati është 3 vjeçar.

Data e mbylljes së konkursit:

- Konkursi është i hapur **15 ditë** kalendarike nga dita e publikimit.

Paraqitja e kërkesave:

- Aplikacioni dhe CV dorëzohen në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, Zyra e Personelit, zyra nr. 1, kati 1. të cilës i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, të diplomuarit në universitetet jashtë vendit t'ia bashkëngjisin dëshminë e nostrifikimit të diplomës, dëshminë për përvojën, dëshminë se nuk është në hetime apo i dënuar për veprë penale dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për vendin e punës.
- Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Për informata të hollësishme mund të kontaktoni me Zyrën e Personelit në numrin e telefonit: **038/20024243** prej orës **08:00-16:00**.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Shëndetësisë/ Ministarstvo Zdravstva/ Ministry of Health

Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale/ Kosovska Agencija za Lekove i Medicinska Sredstva/ Kosovo Medicines Agency

KONKURS

Agjencia Kosove za opremu i lekove u skladu sa clanom 7 zakona broj 04/190L za medicinske proizvode i opremu najavljuje imenovanje sedam clanova komisije KVPPM kao:

1. 3 farmaceuta
2. 1 doktor medicine
3. 1 Doktor stomatologije
4. 1 klinicki farmakolog
5. 1 hemicar, biolog, biohemisar relevant oblast itd.

Mesecna plata:na osnovu sastanaka

Duznost i odgovornost:

-Komisija je odgovorna za pruzanje tehnicke i naucne saveti AKPPM u vezi za izdavanje i odrzavanje marketing dozvole, kao u obavljanje i bezbednost sredstava. Saveti preporucuju Odbor za AKPPM

Odgovorna kvalifikacija:

-Pozicija 1-diploma Univerziteta-Medicinski fakultet, katedra za farmaciju, (minimum 4 godine posle srednje skole) ili barem specilizacija master, doktorat prednost.

-Pozicija 2- diploma Univerziteta-Medicinski fakultet, katedra za farmaciju specilizacija master, doktorat prednost

-Pozicija 3- diploma Univerziteta - Medicinski fakultet, katedra za stomatologiju najmanje specilizacija ili master, doktorat prednost.

-Pozicija 4- diploma Univerziteta - Medicinski fakultet, klinicki farmakologiji specilizacija, doktorat prednost.

-Pozicija 5-Hemijski fakultet, biologije, magistratura od oblasti konkurencije, biohemija –medicine najmanje specilizacija iz biohemije prednost je doktorat.

Sposobnost, Iskustvo, i ostali atributi potrebni:

-Mora da ima sposobnost i postavljanje i ostvarivanje stratski ciljeva institucije, odlicna komunikativost i pregovaracke bestine, dokazano sposobnost da analizira situaciju i obezbedi opcije, osnovno znanje kompjuterskih programa, najmanje 5 godina radskog iskustva, pervenstvo na visokim nivoima i u oblasti koje se odnose na rad Agencije. Znanje Engleskog jezika je potrebno.


Tranje imenovanje: Rok je 3 godine

Datum zatvaranje konkursa: Konkurs je otvoren 15 kalendarski dana od dana objavljivanja

Podnosenje prijava:


CV se dostavlja se u Kosovsku Agenciju za lekove i opremu, kod osoblje kancelarije, br 1 sprat 1 i u pratnji kopije dokumenta na kvalifikaciju, diploma universiteta, inostransva prilozii dokaz nostrifikacije diplome, uverenja za iskustvo, postojii dokaz i istrazi ili usuden sa krivicne delo i dokumentacije druge mere potrebne za radno mesto.

Za detaljnije informacije, možete kontaktirati Kancelariju ljudskih resursa u broj telefona: **038/20024243** od **08:00-16:00**.



Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjejpuneshpejta

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Gjon Pjetraj shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të Sh.F.M.U. "Fan Noli" ne Dujakë KK Gjakovë.
- Shefki Shala shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I.I.II,IV dhe diplomën e Sh.M.T. "Nexhmedin Nixha" – Elektroinstalues, Gjakovë.
- Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , në lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.
- Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.
- Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.
- Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783



ROYAL CROWN
RC
cola

**ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS**

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC
cola

Columbus, Georgia, USA
Since 1909

Columbus, Georgia, USA
0.5L